




FKPKK

Federata Kombëtare e
Pyjeve dhe Kullotave
Komunale, Shqipëri

www.shkpkk.org

Kurora Gjelbër



APPK

Asosacioni i
Pronarëve të Pyjeve
Privatë, Kosovë

www.akppp.org

Gazetë Periodike, Tiranë (Viti i katërbëdhjetë i botimit) Nr. 114, mars 2012 Çmimi 20 lekë

Pylli i fermerit ka zot fermerin

(Çdo tentative për të vazhduar mbajtjen peng të pyllit të tij do të thotë vazhdim i shkatërrimit)

Oferta e Qeverise për t'i gjetur të zotin pyllit ...

Pyjet shqiptare u shkatërruan, pasi qeveritë tona ndoqën politika të gabuara të pronësisë dhe shumicën e lanë jashtë menaxhimit gjatë 50 viteve të fundit. Kjo politikë e gabuar i la shqiptarët më të varfër, shkatërroi pyllin dhe tokën. Fermerit në zonat kodrinore e malore i përgjysmoi për mëse 50 vjet të ardhurat, pasi i mohoi menaxhimin e pyllit të tij, duke e hequr pyllin nga peshorja e të ardhurave kombëtare.

Debati për shkatërrimin e pyjeve, shkaqet dhe pasojat, shtrihet pothuaj në gjithë hapësirën shqiptare. Kjo dëshmon për ndjeshmërinë që ka shoqëria jonë për këtë pasuri të kombit, që nga mënyra se si është trajtuar historikisht dhe pamja që ka e dallon krahinën nga krahina, apo fshatin nga fshati, por dëshmon edhe evolucionin e kulturën e çdo komuniteti apo ndërveprimin e kulturës me natyrën. Për momentin jetojmë një konfuzion të madh kombëtar, si me termin pyll, konceptin e pronësisë, të mbarështimit apo të dëmtimit. Të gjithë janë kundër të gjithëve e, dashur pa dashur, fermerët e zonave rurale dhe institucionet pyjore, trajtohen si shkaktarët dhe viktimat e gjëmës që i është shkaktuar natyrës së kombit.

Qeveria ka dhënë një sinjal që po i ndjen përmasat e shkatërrimit dhe po kërkon rrugëzgjidhje të mundshme. Është koha e duhur që qytetarët e hapësirës shqiptare të përfshihen në këtë debat, për të ndihmuar qeveritë, që të ndërmarrin reformat e duhura. Kjo mund të bëhet duke analizuar ato që kemi bërë në shekullin e fundit dhe pasojat që i kanë

sjellë tokës, peizazhit e jetesës. Por, duhet edhe të kuptojmë me qetësi potencialet dhe pasurinë apo veçoritë e saj në çdo pjesë të vendit, traditat dhe gatishmërinë e komuniteteve për të kontribuar që t'i rikthehet ve-shja drusore tokës sonë.

Toka, natyra dhe popullsia rurale, gjithmonë janë përpjekur për t'u pajtuar e bashkëvepruar me zgjidhje të qëndrueshme. Shoqëria jonë, ashtu si çdo shoqëri tjetër, ka evoluar në këtë bashkëjetesë me natyrën, tokën e drurët, si bazën e ekzistencës e të ardhmës së saj, duke kombinuar bilancin mes atyre që merr, inputeve, siç janë energjia, oksigjeni, ushqimet, lëndët e para dhe atyre që mbeten, siç janë mbeturinat, gazi karbonik apo jashtëqitjet, me vetitë e sistemeve pyjore për t'u rinovuar në mënyrë ciklike. Asgjë e re nuk është thënë, kur pohohet se ata që merren apo inputet, vijnë përgjithësisht nga industritë primare, si bujqësia, pylltaria, apo energjia, e kjo duhet të mbështetet si parakusht, për t'u bërë shoqëri e qëndrueshme. Kjo fjalë është mbipërdorur vitet e fundit, por pikërisht pylli i fermerit është një sistem e teknikë mijëra-vjeçare plotësisht e qëndrueshme. Për pjesën lindore, nga Kopliku në Leskovik, në shumicën e familjeve rurale, që nga lashtësia deri më sot, ferma pyjore dhe për Labërinë ferma kulllosore, kanë qenë historikisht më të rëndësishme për jetesë sesa ferma bujqësore. Ndërsa ferma bujqësore në prefekturën e Kukësit, raportohen 0.52 ha për familje, nëse do të legalizohej bashke me pyjoren e kulllosoren do i kalonte tre hektarë, në Puke ferma bujqësore zë rreth 10-15 % të asaj pyjore, në prefekturën e Dibrës, ferma bujqësore legale 0.58 ha, nëse do legalizohej pylli i fermerit sipërfaqja e fermës për familje do i kalonte 2.5 ha. Pra, pylli i fermerit ka qenë dhe mbetet



pjesa mbizotëruese e fermës dhe burimi kryesor i të ardhurave të banorëve ruralë nga toka. Përkundrazi, deri më tash juridikisht, në rrugën drejt modernizimit, popullsisë sonë rurale nuk po i jepet shansi për t'u pronësuar e punësuar, duke kontribuar për të ringritur një sistem menaxhimi, për të prodhuar, nga toka e destinuar për pyje e kullota, që aktualisht zë gjysmën e territorit të vendit. Për shkak të shtetit, pylli i fermerit, si sistem tradicional, u hijezua e më pas humbi pikërisht në 50 vitet e fundit, bashkë me objektet e kultit e tradita e zakonesh të lashta të popullit dhe po për shkak të injorancës e papërgjegjësisë së shtetit, shfrytëzimi i kësaj pasuri ka disa 10 vjeçarë që bëhet spontan e shkatërrues, duke zbuluar, degraduar e eroduar token. Institucionet shkencore e ato administrative, si në regjimin e kaluar edhe më pas, të orientuara përgjithësisht drejt pylltarisë moderne, nuk u angazhuan për ta njohur pyllin e fermerit apo paralajmëruar pasojat e rrëzimit të atij sistemi e shfrytëzimin spontan e në anarshi të plotë të pyllit.

Është e nevojshme një analizë e reflektim se sa kemi humbur, si dhe të vendosim për të ndaluar degradimin galopant të mjedisit, që po shoqërohet me pasojat të rënda mbi

sistemin prodhues të energjisë elektrike, atë rrugore, rezervat ujore, me reflektim tepër serioz në të gjithë spektrin e jetës shoqërore e me dukuri negative, që po shtohen progresivisht vitet e fundit. Jo vetëm që nuk merret biomasa, por pas prerjes së drurëve ka filluar degradimi e shkatërrimi i tokës. Kjo po ndodh në sy të të gjithëve, në stadin kur pretendojmë se kemi hyrë në rrugën e një shoqërie të zhvilluar e moderne. Ka një mungesë e ç'orientim total, si për shkaqet, ashtu edhe për zgjidhjet. Në shkallë kombëtare, kemi humbur instrumentin që lidh njeriun me trajtimin e kësaj pjese të tokës, prej ku njeriu punësohet e fiton, toka rigjallërohet e prodhon. Toka e gërryer, me bimë të saktuara, ka nevojë për dorën e njeriut, me të cilin ka ardhur deri këtu në një bashkëjetesë mijëra-vjeçare. E, që të ringjallet, lypset të bëhet e vlefshme për njeriun.

Edhe në angazhimin aktual të qeverise e në debatin që po e pason, ndërmjet rreshtash kërkohet pronari legjitim, pra pronari që ka dokumente, duke u lënë të kuptohet se pjesës së pyllit që nuk i del pronar me dokumente juridik, do të studiohet që të gjendet në forma të tjera pronari! ...

Shumica jonë është dëshmitare që banorëve që jetojnë në zonat rurale, bashku-dhëtarë shekullorë me pyllin e kullotën, nuk u është njohur ndonjëherë e drejta ligjore, për të menaxhuar tokën e tyre pyjore e kulllosore. Ky nuk është slogan. Ky është fakt, që shqiptarët banorë të zonave rurale e marrin pothuaj të gjithë drurin për ngrohje, pa sistem menaxhues për të prodhuar këtë mall, si dhe pa leje. Me fjalë të tjera, në formë pothuaj ilegale, në mes të ditës, atje ku mundin, pasi pothuaj për çdo fshat apo familje, pronari i

Vijon në fq. 2

Shoqatat e Pronarëve të Pyjeve Privatë të Kosovës – në ndërrim të viteve

nga ARDITA DINAJ

Në ditën më të shkurtër të vitit të kaluar, pikërisht me 22 dhjetor, Shoqata Kombëtare e Pronarëve të Pyjeve Private të Kosovës, së bashku me shoqatat komunale, shfle-tuan punën, të arritura gjatë vitit 2011 dhe planin e veprimtimit për vitin 2012.

Të ndalesh në një përshkrim të veprimtarisë së këtyre shoqatave, me pak fjalë e gjen punën që kanë bërë prej ditës së themelimit, pasi nuk është kohë

e gjatë qysh se kanë filluar së vepruari. Të gëzon fakti se këto shoqata me kryesinë punëtore janë unike mes veti dhe veprojnë në shërbim të pronarëve të pyjeve dhe gjithë komunitetit. Në këtë takim, edhe pse fundviti, dukej se diçka ka filluar të bëhet dhe viti i parë i funksionimit të tyre iku si pa u kuptuar. Atë ditë dukej se nuk do t'i nxinte salla, pasi tani numërohen 16 dhe duken si ombrellë e Shoqatës Kombëtare, e cila



në fillim të vitit 2011 dukej disi e vetmuar dhe e paskrahë, ndërsa sot edhe pse ombrellë e të gjithave, dukej më e ngrohtë e më e fuqishme.

Mungesa e organizimit të pronarëve të pyjeve privatë ishte një nga çështjet kryesore në menaxhimin e pyjeve privatë. Kështu përpjekjet për krijimin e shoqatave të pronarëve të pyjeve filluan nga viti 2005, kur me mbë-

Vijon në fq. 5

Mangësi që s'duhet të vazhdojnë pafundësisht

NDRIÇIM ÇELA
Federata Rajonale, Elbasan

3

Reformat në pyje kërkojnë mbështetje në tradita dhe në përvojën e fituar ...

XHELAL SHUTI
Federata Rajonale, Kukës

4

Magjia e natyrës dhe bota virtuale

nga LUAN AHMETAJ

7

Kudo stres

nga SHPËTIM MYRTO

7

Damkosësit e pyjeve

nga NIJAZI IDRIZI

5

Druri, mrekulli natyrore

nga MIFTAR LOKAJ

6

Pylli i fermerit ka zot fermerin

Vijon nga fq. 1

pyllit që pas luftës së dytë botërore është vetëquajtur shteti, ai qendror apo lokal, i cili asnjëherë nuk ka deklaruar një plan se kush, ku, sa e si të prodhojë drurin për ngrohje apo gatim. Banorët ruralë e kryejnë këtë punë ilegale të sulmuar nga shteti, media, polici, gjykatësi apo eksperti, si të ishin pushtues të tokës ku banojnë. Ajo pak sasi e pyllit, që shitet në sistem nga shërbimi pyjor i shtetit, shitet me tender. Sasia vjetore e shitur në 20 vitet e fundit ka qenë për të mbuluar rreth 10 % të nevojave të popullsisë. Nuk besojmë se e kundërshton njeri argumentin me të cilin u fillua: tokën pyjore shqiptare, që përbën gati gjysmën e atdheut tonë, e kemi aktualisht në përdorim spontan jashtë çdo kujdestari, sistemi menaxhues apo legal.

Pylli i fermerit - sistem i lashtë silvopastoral

Drurët që i ka falur natyra tokës tonë, janë të shumtë e fort të mësuar për të bashkëjetuar me agresivitetin e njeriut mesdhetar. Ata e populluan tokën tonë miliona vite para nesh. Më pas erdhën njerëzit e i ngritën banimet e tyre pikërisht rrëzë drurëve, kryesisht dushqeve, por në rrethana të caktuara edhe me të tjerë. Drurët iu përshtatën, ashtu si edhe kafshët e zbutura, kërkesave të njeriut. Ndryshe nga reflektimet e banorëve urbanë, pas prerjes së çdo druri, që gjerësisht e gjykojnë si vdekje të tij, çdo kush që thellohet e ka dije elementare mbi ripërtëritjen vegetative të pyllit, e kupton që media ka dhënë lajm të preferuar qartë, nëse prerja është bërë në pyllin faror apo vegetativ, druri i pyllit të fermerit rilind, bilë me ritëm të shpejtë, menjëherë pas prerjes, kur është nën kujdesin e pronarit. Banorët lokalë, ndoshta autorë të këtij adaptimi, i mësuan shpejt këto sekrete e lëshime që u bënte natyra dhe filluan sipas vendit e burimeve natyrore që kishin, të përshtateshin. Hap pas hapi ata mësuan që lastarët që dilnin nga cungu t'i linin të rriteshin deri në ato përmasa që u duhej, duke e ndarë pyllin në pjesë, për të pasur për të prerë e lënë për të rritur, ashtu siç ndanin edhe kullotën apo gjerat bazë të ekzistencës.

Mrekullia qëndron në faktin, që rrënjët e këtyre drurëve, apo më sakte llojet drusor përbërës të këtyre pyjeve, janë pothuaj ata që e kanë populluar që nga fillimi tokën tonë, pra janë lloje natyrore e autoktone, pasardhës të pyllit të virgjër, që vuri në trajtim njeriu primitiv. Ky pyll ka ndryshim esencial, nga pyllëzimet që ka bërë shteti, psh me pishë, akacie apo plep, pasi në këto raste është mbjelle dhe

është imponuar për tu rritur një lloj pyjor që nuk e ka pasur më përpara vendi, ashtu siç mbillet për shembull misri apo patatja, që janë të ardhur nga kontinentet e tjera.

Këto sisteme u përshtatën, në përputhje me rrethanat e vend banimit, si thjeshtë për prodhimin material drusor, me rotacione, sasi e përmasa të dëshiruara, ashtu edhe duke kombinuar, prodhimin e drurit, me bazën ushqimore e kullotjen e blegtorisë. Këto sisteme menaxhuese kanë arritur deri në ditët tona. Duket si detaj shpjegimi i tyre, por vetë konfuzioni dhe moskuptimi nga politikë bërësit e bën të domosdoshëm tregimin e këtyre detajeve, jo fort të dëshiruara, shpesh fort të kritikuar si kasaphana, nga administrata dhe ekspertet e pyjeve. Ky sistem prodhues, për banorët ruralë, ngjante me një fabrikë të thjeshtë, që harxhon kohë për tu ngritur e më pas prodhon në vazhdimësi. Ishte një projekt shumë fleksibël, që çdo familje, e adoptonte lehtë, duke tentuar që për çdo vit të punonte në një pjesë të territorit (shpesh një të tretën), që i ishte pranuar nga fqinjët bashkëfshatarë, ku sipas rrethanave kishte vënë edhe kufij, të cilët sot e kësaj dite qëndrojnë në tokë, por nuk janë legalizuar apo njohur nga shteti.

Si u ngrit pylli i fermerit "apo sistemi silvopastoral"

I bazuar në manipulimin me prerje vegetative, varësisht kushteve ekologjike, pjellorisë së tokës, llojit të drurëve e nevojave të fermerit, sistemi merrte emërtimet përkatëse si kashnjet, hamalle, prozhëm, zabel, ograjë, korie, mal ... Në esencë synimi ishte që materiali drusor të prodhohej për çdo vit, si gjatë ngritjes ashtu edhe pas stabilizimit të sistemit. Ajo që druri i sapoprerë lë trashëgim janë lastarët që dalin nga cungu apo rrënjët e prindit. Që në lashtësi fermeri e dinte këtë dhe në varësi të qëllimit që kishte, nëse do bënte vend për kullotje, bazë ushqimore për dimër e prodhim druri, i duhej që pas tre viteve që i linte lastarët për tu rritur, t'i rrallonte ata fort, duke marre prodhimin e parë e duke lënë një numër të caktuar për të shkuar në lartësi. I rikthyer në këtë vend pas tre vitesh të tjera, kur druri "për mbarë" kishte mbushur 6 vjet, fermeri përsëri bënte prerje të gjithë lastarëve të rritur gjatë trevjeçarit, poshtë "drurëve të lënë për mbare". Tani ishte e mundur që, edhe "drurëve për mbare" t'u bëhej trajtim, duke u prerë degët e krijuar nyjat prodhuese, që te fillonin prodhimin në disa kate.

Në momentin e sapoprerjes, i gjithë ndriçimi i diellit në pranverën pasuese arrinte në

tokë, duke nxitur çelje të shumë barërave e lastarëve drusorë, duke u shndërruar në kullotë për gjithë llojet e blegtorisë. Për kafshët e egra, gjiatë, zogj e të tjerë, dukej tepër e preferuar, pasi në hapësira të ngushta krijonte çeltira e vendstrehime, si dhe ushqim shumëllojesh. Ndriçimi vinte në pakësim deri në vitin e tretë, ku tashme prodhimi sigurohej nga "drurët për mbarë" që ishin rritur e me prerjet e bëra ishin imponuar për të krijuar, arkitekturë speciale të kurorës në disa kate, me disa gunga prodhuese, ku takoheshin e ndaheshin druri i ri, që vilej periodikisht, me të vjetrin, që në një anë prodhonte për pronarin e në tjetrën rriste katet dhe përmasat e trupit të tij, që lidhte tokën me diellin, një sistem që jepte kullotë për çdo vit e biomase për ushqim e energji në çdo tre vjet. Në dimër gjethi ushqente në grazhd blegtorinë, pjesa e drunjtë digjej ose përdorej për nevoja të tjera të fermës. Ky sistem primitiv prodhues, që kërkonte përkushtim të përvitshëm e volum të konsiderueshëm pune, nga ana tjetër siguronte shumicën e drurit për ngrohje e nevoja të tjera për shumicën e familjeve të zonave kodrinore e malore, ka funksionuar në shumicën e zonave rurale me dimër të ftohët e me borë, qysh kur njeriu filloi të ushtronte parabujqësinë primitive, që studimet arkeologjike në Evropë e datojnë mbi 6000 vjet e deri në vitet 1950-1980, kur shteti filloi kolektivizimet, zhdukjen e trashëgimisë fetare, si dhe të traditave e zakoneve të vjetra të jetesës, duke e futur për fat të keq edhe këtë sistem në listën e zezë, ndoshta ngaqë ishte rregulluar me kanun! e duke i dhënë goditjen finale me tufëzimin e blegtorisë dhe centralizimin e gatimit të bukës së fshatit. Për fatin e keq, si të fermerit edhe të pyllit, në të shumtën e herës si shtëpinë ashtu edhe tokën e pyllit, kolektivizimi apo tufëzimi, ia gjeti pa dokumente ligjore. Meqë shtëpia nuk arriti të tufëzohet, shtëpia shpëtoi, ndërsa blegtoria pothuaj u zhduk e u rikrijua, për pyllin kalvari vazhdoi, dhe sistemi, si në heshtje, u fut në listën e zezë të traditave e zakoneve prapanike. Evropa e pati përdorur këtë sistem deri në shekullin e XIX, si për shkrirje minerale, ngrohje e vende-vende blegtorie, zbulimi i qymyrdurrit e gazsjellësit e konkurruan në treg dhe pylli u përshtat për të prodhuar lëndë punimi, letër, ajër e ujë. Te gjithë pyjet vegetative apo cungishtet kanë një gjë të përbashkët, - ata priten në mënyrë të përsëritur, me pritjen e arsyeshme që drurët do të rriten përsëri pa ndihmën e askujt, me kusht të mos dëmtohen filizat që çelin nga cungu. Nëse kjo gjeneratë që fillon menjëherë rritjen vjen nga lastari i cungut, i rrënjës apo nga fara, kjo nuk është esenciale, esenciale është që mbulesa e re formohet në kohë të shkurtër dhe për pjesën dërmuese vegetative, e vetmja punë që harxhohet është vjelja e prodhimit drusor. Procesi është deri në infinit i përsëritshëm. Ka territore në Evropë që janë ricunguar për periudha shumë të gjata të jetës së tyre, shpesh për qindra apo mijëra vite. Në cungishtet e menaxhuara, për çdo vit priten 0.5-10 % e sipërfaqes, ndërsa tek pyjet e lartë natyrorë 0.5-2 % e tyre (Buckley 1992). Në Shqipëri, me shtimin intensiv të popullsisë në shekullin e kaluar, si dhe për mungesë të gazit natyror apo alternativave të tjera për ngrohje, kërkesa në treg është shtuar shumë. Sistemi i krijuar nga fermeri, prodhon shpejt e lirë, pasi është afër, nuk harxhon lëndë djegëse për transport, drurët janë të hollë e priten më lehtë. Shkaktërimi e abandonimi i sistemit, e orientoi kërkesën e lartë për dru për ngrohje drejt pyllit të lartë e veçanërisht pyjeve të ahut. Ky i fundit, i menaxhuar historikisht me objektiva krejt të ndryshme e me afate të gjata kohore, u pre e u shkatërrua pothuaj tërësisht.

Krasitja dhe ricungimi, traditë e prapambetur apo trajtim shkencor për të rritur prodhimin?

Ricungimi, prerjet apo krasitje të ndryshme janë ushtruar nga njerëzimi në 6000

vitet e fundit, duke drejtuar prodhimin bimor në interes të jetesës. Opinioni e pranon termin e trajtuar nga shkencat bujqësore, veçanërisht si trajtim të pemës për prodhimin frutash, e përshtatur sipas kërkesave të çdo druri drurët pyjorë. Të dyja me origjinë vegetative, si parakusht për rritje të shpejtë, e kundërta e pyllit natyror me origjinë farore e me rritje të ngadaltë vitet e para, për fermerin, duket se pema është një dhe trajtimin e përshtat sipas destinacionit, pra për prodhimin fruti, ose biomase. Pikërisht kjo bën dallim esencial në zbatim, duke përdorur shpesh edhe terminologji të ndryshme nga rasti në rast. Krasitja e drufutoreve, synon të nxisë formimin e sythave frutorë, duke prerë lastarë, degë apo bisqe, duke u mundësuar atyre që janë në pozicion të favorshëm të përdorin me efektivitet dritën e diellit, e cilësuar si "korrie e diellit". Krasitja apo shkadhita e drurëve pyjorë ka për objektin shtimin e asaj pjese vegetative që i duhet pronarit dhe përgjithësisht ka si princip që sythat vegetativë të kenë mundësi të barabarta për tu ekspozuar karshi dritës së diellit. Ndërsa në rastin e pemëve frutorë, objektivi i krasitjes është rregullimi maksimal i raporteve të sythave frutorë me dritën e diellit, në rastin e drurëve që prodhojnë biomase, objektivi është rregullimi i sythave vegetative në raport me dritën e diellit. Të dyja këto mjeshtri janë zbatuar nga fermeri dhe kanë evoluar që nga lashtësia. Trajtimi bëhet për të shpejtuar e shtuar prodhimin, pra është punë që fermeri e vlerëson që ia shpërblen. Në këtë kuptim, drurët që i nënshtrohen këtij trajtimi, për të prodhuar biomasë, gjethe, shkarpa, thupra, hunj, dru, apo lëndë ndërtimi, kanë qenë historikisht pjese e fermës bujqësore, dhe qëndrojnë larg termave dhe parimeve të menaxhimit që aplikohen nga ekspertët e pylltarisë moderne objekt i shkollave tona pyjore, të orientuara kryesisht tek pylli i lartë, me origjinë farore e me cikël përgjithësisht shekullor. Në librin më autoritar të pylltarisë shqiptare në vitin 1955, Ilia Mitrushi do shkruante që shpardihi si pyll i ulët rekomandohet të trajtohet me qarkullime 18-25 vjeçare, dhe në toka të trasha jep deri 30 mst dru për ngrohje në vjet, dmth 540-750 mst dru për ngrohje në një hektar brenda një turni 18 deri 25 vjeçar, ndërsa një hektar pyll i ulët qarri jep sipas kualitetit të tokës ku rritet prej 10 deri në 40 metër ster dru për ngrohje në vit, me rotacion 14 vjet, pohime për sasi rreth 10 deri 20 herë më të mëdha nga ato që arrihen të prodhohen aktualisht, e çuditërisht këto të dhëna të vërtetuara në shumë raste në pyjet e fermerëve, nuk u përfshinë në librat për nxënës apo studentë të pylltarisë që u hartuan pas viteve 1960.

Shumica e ekspertëve të pyjeve e vlerësojnë menaxhimin tradicional me drurë të ricunguar apo të krasitur, si të dëmshëm, që çon shpejt në degradim, shëmton peizazhin dhe pakëson diversitetin. Autorë të ndryshëm, që kanë studiuar reagentin fiziologjik të drurëve të ricunguar apo krasitur, i argumentojnë këto ndërhyrje me ndikim pozitiv në rritje të jetëgjatësisë së drurit apo shtim të biodiversitetit. Fontanier dhe Jonkers (1976) psh, theksonin që një krasitje e rëndë e degëve apo trungut kryesor, ka efekt pozitiv, pasi vonon pleqërinë e drurit. Ajo shkurtonte transportin e brendshëm në dru dhe përmirëson furnizimin e periferisë së kurorës së drurit me ujë e lëndë ushqyese. Kjo mund të jetë pasojë e rilindjes fiziologjike. Krasitja gjithashtu nxit sythet e rinj apo indet, të formojnë lastarë normalë apo adventivë, ata që janë më të rinj se sa ata që hiqen. Kjo trajtohet si rilindje gjysmë ortogjenetike. Një dru reagon karshi krasitjes vegetative, duke ndërtuar masë të dendur fibrash rreth pikave të prerjes, i reziston tharjes dhe e ndan në mënyrë efektive rritjen e re, nga pjesa e trungut të vjetër (Harris, etj., 1999). Kështu integriteti mbrojtës dhe strukturor i drurit maksimizohet, përgjithësisht

Vijon në fq. 3

"T'i tregojnë babait arat"

Gjenerata e sotme nuk është as e para dhe as e fundit përdoruese e tokës dhe mjedisit. Me qindra gjenerata, që jetuan para nesh, provuan, mësuan e na dhuruan jetën, tokën e mjedisin. Çuditërisht, dy shekujt e fundit njeriu sikur u deh nga industrializimi. Apo ëndrra e urbanizimit. Njerëzit e zonave urbane e harruan origjinën, duket se u dashuruan me mekanizimin dhe prodhimin e lartë, shpesh artificial, e mbyten fshatin me lëndët larëse e lavatriçet, që kanë helmuar pothuaj gjithë ujërat e globit, duke zhdukur që nga peshqit e çdo gjë të gjallë tjetër. Përgjithësisht gjykimi i tyre karshi traditës së banorëve ruralë ishte skeptik dhe, duke shfrytëzuar qeveritë e mediet, shpesh edhe shkollat, që shtrihen në territorin e tyre, filluan "t'i tregojnë babait arat", apo të mësojnë kultivuesit e vreshtit "si bëhet vera apo rakia", duke prodhuar shpesh ligje apo sisteme prodhuese, që pengojnë banorët ruralë të sillen me natyrën si të parët e tyre e duke imponuar shpesh nonsense.

Mësimi që vjen qysh nga lashtësia është që ne mund të punojmë me natyrën e të vjelim prej saj atë që ajo na ofron, në atë mënyrë, që t'i shkaktojmë sa më pak shqetësime dhe t'i mbajmë pyjet të bukur e prodhues, si për njeriun, ashtu edhe për llojet e tjera që banojnë në globin apo shtëpinë tonë të përbashkët ...

Në përgjigje të ftesës së FKPKK për të marrë pjesë në debat e kontribuar në hartimin e një Ligji sa më jetëgjatë për pyjet, vazhdojnë të vijin mendime e propozime, të cilat jemi përpjekur t'i sjellim në faqet e Gazetës ...

NDRIÇIM ÇELA

Federata Rajonale, Elbasan

Në këto pak radhë po sjell disa dukuri që janë venë rë gjatë procesit të transferimit të fondit pyjor në Njësitë e Qeverisjes Vendore (NjQV). Federata e qarkut tonë është përpjekur të bëjë sa më mirë avokatinë për pasurinë pyjore dhe të gjitha burimet e tjera natyrore, gjithmonë në të mirë të komunitetit e sidomos të përdoruesit real të tyre. Por, me gjithë arritjet, mendojmë se ritmet e transferimit janë ende të ngadalta, kryesisht sepse:

* Aktorët pjesëmarrës nuk e kanë ndjerë si duhet përgjegjësinë që kanë në realizimin e kësaj reforme të rëndësishme për ekonominë dhe fermerin shqiptar.

* Akoma nuk janë njohur ligjërisht kufijtë midis fshatrave, midis komunave po edhe midis rretheve.

* Përdoruesit nuk kanë asnjë dokument që të vërtetojë të drejtat e përdorimit apo pronësisë mbi atë pyll/kullotë apo të ndonjë burimi tjetër natyror.

* ZRPP nuk kanë regjistruar në asnjë rreth transferimin e kësaj pasurie të madhe.

* Ka mangësi në kuadrin ligjor, lidhur me të drejtat e pronësisë e të përdorimit, si:

- Përqendrimi i kompetencave në organet shtetërore edhe për çështje që duhet t'u takojnë NjQV.

- Ka mospërputhje e mbivendosje kompetencash midis disa ligjeve për administrimin dhe kadastrën e pyjeve dhe kullotave komunale, për kundërvajtjet, lejet mjedisore, gjobot e sidomos vjeljen e tyre.

- Të drejtat e përdorimit nuk janë të plota e të qarta për pyjet e kullotat që i jepen në përdorim fshatit dhe familjeve, sepse mungojnë dispozitat ligjore.

- Nuk është përdorur i njëjti matës për transferimin e pasurisë pyjore në NjQV. Psh. ne rrethin e Elbasanit vetëm 4 komuna nuk i kanë marrë në pronësi pyjet e kullotat komunale.

Komuna Rajcë ka probleme me pronësinë, ashtu si edhe Stebleva, Hotolishti, Tunja, etj. Prandaj ritheksojmë se "të drejtat e përdorimit nuk janë të qarta e të plota për të gjithë pasurinë pyjore në kuptimin e gjerë të fjalës", sepse:

- Mungojnë dispozitat ligjore, kriteret dhe rregullat e menaxhimit e të shitjes së materialeve drusore e jodrusore nga përdoruesit dhe shoqatat me qëllim rritjen e të ardhurave të tyre.

- Mungojnë kriteret për kalimin e pasurisë pyjore nga përdorimi ne pronësi të përdoruesve (ata i dine e i ruajnë edhe vetë, por kriteret ligjore janë të domosdoshme).

- Mungon rregullimi me ligj i marrëdhënieve midis qeverise qendrore e NjQV, midis NjQV e përdoruesve (fshat/fis/familje) dhe Shërbimit Pyjor e pronarëve privatë. Pra, nuk ka struktura lidhëse për këto probleme.

- Mungojnë kompensimet që duhet të marrin përdoruesit dhe shoqatat për kufizimet që bëhen nga ligjet për parqet kombëtare, zonat e mbrojtura, pasuritë ujore e minerale, zonat turistike deri dhe

ushtarake, që ndodhen në territorin e tyre.

Federata Rajonale e Elbasanit edhe ne takime të tjera lokale, e ka ngritur zërin për këto probleme. Por ka një kontradiktë interesante. Pranë qendrës ka një lob konservator, që i mbyll problemet dhe logjikon se janë ata më afër pasurisë pyjore me të gjithë përbërësit e saj e po nuk u bë ashtu si thonë ata "pasuria pyjore u shkatërrua". Por, ekziston edhe një lob tjetër, më tolerant, më liberal në gjykim, që thotë se më afër se kushdo me pyjet, kullotat e çdo burim tjetër natyror, është fermeri me interesat e tij. Federata Rajonale mbështet këtë grupim, pasi arsyet se është në të mirë të zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit të pyjeve.

Shembuj të ruajtjes e zhvillimit të pyjeve dhe pasurive të tjera natyrore këto dy dekada ka shumë. Hidhini një sy grykës së Shkumbinit dhe shikoni se si është rritur e zhvilluar pylli, hidhini një sy kalimit të ujërave të kthjellëta e të ëmbla dhe shikoni se si është zhvilluar trofta në rezervatet private etj.

Ne vazhden e ndikimit të shume aktiviteteve që janë zhvilluar ne kuadrin të transferimit të Pasurisë Pyjore ne NjQV, pa paragjykuar DSHP se edhe ato kane bere shume pune ne kushtet e një mungese eksperience e të një kuadri ligjor jo të plotë, ne shume komuna janë bere edhe gabime, si pasoje e përgatitjes se njëanshme të dokumentacionit nga DSHP. Shume kryetare komunash firmosen, procesverbalin e transferimit pa

shkelur me këmbë e pa pare me sy parcelat ose me mirë pasurinë pyjore që do të merrnin ne pronësi. Kjo edhe sepse kryetaret e komunave nuk e njihnin mire gjendjen e nuk janë specialistë pyjesh. Prandaj jemi sot ne një situatë "hidh e prit", siç thotë populli.

Natyrisht, një informacion nuk mund të evidentojë të gjitha problemet shqetësuese të pagjidhura gjatë këtij procesi të thelle reformash. Por ajo që është më e rëndësishme për ne duhet të jetë edhe për aktorët e tjerë, që marrin pjesë në realizimin e reformës në pyje dhe në tërësi të burimeve natyrore.

Duhen gjetur rrugë për të administruar pasurinë pyjore atje ku ka vendin. Botanisti i njohur Antonio Baldacci, këtu e një shekull më parë theksonte se zhvillimi i bujqësisë shqiptare lidhet edhe me problemin e pylltarisë. Por, ka një vështirësi nënvizonte ai: "... vërtetimi i pronësisë së Pyjeve të Shqipërisë. Para së gjithash duhet stabilizuar se cilat janë në pronësi private, cilat në përdorim të përbashkët e cilat shtetërore, për të shmangur kundërshtimet që lindin me mijëra dhe nxjerrin vështirësi që nuk do të jetë lehtë për t'u kapërcyer nga qeveria".

Këtë radhë duhet bërë kujdes që defektet e ligjit 7501 të mos përsëriten për pyjet e kullotat. Kodet mijëvjeçare (të pashkruara por veprojnë edhe sot) të krijuara nga komuniteti në rrjedhën e shekujve për administrimin e pasurisë pyjore. Disa nga

mendimet e strukturave të nivelit të parë të NjQV, Shoqatave e PPKK dhe përdoruesve realë janë:

- Hartimi e miratimi urgjent i një ligji të ri, që ne përmbajtje të përfshijë pronat dhe pronarët ... bazuar dhe ne objektivat madhore që përcaktoi Kryeministri, kur tha: "... vetëm 10% të pyjeve duhet të mbajë shteti se nuk mund të menaxhojë më shumë, pjesa tjetër të ketë pronar komunat dhe përdoruesit tradicionalë". Ligji i ri, krahas qartësisht të të drejtave të pronësisë, lypset të qartësojë edhe rolin e të gjithë aktorëve, përgjegjësitë e tyre, si dhe të përcaktojë rregullat e regjistrimit dhe kriteret e përdorimit, për të filluar menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm. Po ashtu, duhen krijuar menjëherë strukturat në zbatim të ligjit të ri dhe detyrave që dalin me vendimet përkatëse ...

- Të forcohet bashkëpunimi midis këtyre strukturave (NjQV – SHPPKK - DSHP) për lehtësimin e procesit të transferimit të pyjeve e kullotave komunale në mënyrë organike.

S'mund te mohojmë arritjet në transferimin e pasurisë pyjore, por duhet të pranohet se jemi të vonuar në realizimin përfundimtar të këtij procesi. Qeveria, me vendimet e marra, ka kryer dhe vazhdon të kryejë vetëm kalimin formal të pasurisë pyjore në NjQV, por këtij veprimi nuk i është bashkëngjitur përmirësimi ligjor dhe veprimet e shume strukturave, si Agjencia e inventarizimit dhe regjistrimit të pronave të paluajtshme, ZRPP e aktorë të tjerë pjesëmarrës në realizimin e kësaj reforme.

Pylli i fermerit ka zot fermerin

Vijon nga fq. 2

këto krasitje realizohen tek drurë që i nënshtrohen që në rini këtij procesi, duke krijuar ndjeshmëri të lartë biologjike dhe reagim mjaft shpejt të qelizave të gjalla karshi plagëve që shkakton prerja, apo ndryshimeve mjedisore, duke ndërtuar reaksion të fortë mbrojtës (Coder, 1996).

Drurët e trajtuar përveç sa më sipër zhvillojnë një rilindje të vazhdueshme si dhe një kurorë të re me energji krijuese, mbi kokën e një trungu të vjetër në rritje. Kjo ngadalëson proceset normale të mplakjes së drurit. Në cingërshtet e menaxhuara mirë, nuk ka nevojë për herbicide apo plehra, nuk është nevojë të gërmohet toka apo mbillen drurë, nuk ka nevojë të lihen drurë për hije apo ujitje. Pas ricungimit apo krasitjes, akoma pa kaluar viti, një revolucion i vërtetë realizohet, e gjithë sipërfaqja e pyllit bëhet një skenë e paimagjnueshme e jetës që shpërthen, ku lastarët që dalin nga sythat e drurëve, janë në garë me lule shumëngjyrëshe, insekte, flutura, zogj e gjitarë. Pra, përveç prodhimit të drurit e kullotjes, ky vetërinovim apo rilindje, i jep fermerit prodhime me kosto mjaft të arsyeshme, të investuar thjeshtë për ngritjen e sistemit apo vjeljen e prodhimit. Fleksibiliteti i tij dhe përshtatja sipas nevojave, i krijon mundësi të jashtëzakonshme pyllit dhe fermerit, për të dhënë prodhimin që kërkohet, në përmasat e duhura, duke e mbajtur tokën të mbuluar e ekosistemin pyjor ne funksionim të plotë.

Pyll apo pyll fermeri

Këtu është rasti të ndahet kuptimi i fjalës pyll sipas përkufizimit modern, me termat popullore që përdoren për këto drunishte bujqësore, si zabel, prozhëm, ograje, korije, purend, mezhde, kashnjet, hamalle ... Pylli ka karakteristikë shtrirjen masive të drurëve në sipërfaqe të gjera. Në kushtet e sotme tek ne ato shtrihen mbi zonat përgjithësisht të banuara, ku zhvillohet bujqësia, në zonat fitoklimatike ku rritet ahu, pishat, bredhat, etj. Pra, pylli klasik modern, përbëhet përgjithësisht nga drurë, që me pak përjashtime, nuk janë ndikuar nga njeriu për formën e kurorës, apo për të dhenë një produkt të caktuar. Ata janë rritur përgjithësisht në mënyrë natyrore. Njerëzit kanë marrë prej tyre lëndën e drurit për ndërtime apo punime druri, si dhe gjatë stinës se verës kanë marrë drurë të tharë, për t'i përdorur si kompensim për pjesën, që nuk e siguronin nga drunishta e tyre bujqësore, me emrat e përshtatur sipas zonave gjeografike dhe kushteve.

Përdorimi i një emërtimi të përbashkët, "pyll", si për shkurret, drunishte bujqësore, që kanë qenë historikisht "pyll i fermerit", duket se ka qenë pika e fillimit të konfliktit të shteti me individin dhe pika e fillimit të menaxhimit ilegal, jashtë sistemit. Në kushtet aktuale të Shqipërisë, këto drunishte janë pjesë e aktiviteteve bujqësore, që sigurojnë prodhi-

me shumë të rëndësishme dhe që në mungesën e gazit apo lendeve të tjera djegëse apo edhe të infrastrukturës së saj, mund të konsiderohen për momentin si burim punësimi, prodhim bioenergjie dhe i vetmi "shpëtimtar" i pyllit malor. Kjo pjesë e drunishtave dhe e menaxhimit është krejt e panjohur, e futur në kategorinë pyll dhe orientimet teknike që rekomandohen nga shteti, përgjithësisht ndikojnë për keq, si në prodhimtari edhe në zhvillim.

Zhdukja e pyllit të fermerit

Fillimet e kolektivizimit të tokës, u shoqëruan me propagandë intensive për ndryshimin e mënyrës së jetesës. Bashkë me tempujt e fesë apo kanunin, që kishin kontribuar në vendosjen e kufijve apo të rregullave në përdorimin e pyllit e të kullotës, dalëngadalë filloi të avanconte psikologjia sa që traditat apo dëshira e fermerëve për të tilla praktika menaxhuese të konsideroheshin të dëmshme. Tufëzimi i plotë i bagëtisë së imët, shënoi heqjen e komponentit themelor të sistemit dhe, për pasojë, fillimin e shembjes së sistemit shumëshekullor silvopastoral (silvokullo-sor). Shkatërimi erdhi vetvetiu, fermerit i mungonte nevoja pastorale/kullosore, ai nuk kishte më arsye për t'u drejtuar drejt një së tretës së pyllit të tij, pasi nuk i duhej kullotë apo gjeth si bazë ushqimore për dimër. Shteti kishte marrë përsipër të mbarështonte edhe blegtorinë e tij. Nuk gjendet ndonjë dokument që të dëshmojë, nëse i është bërë analizë impaktit të këtij vendimi. Është e lehtë të mendohet, që fermerët e ekspertët e pylltarisë nuk ishin autorë të këtij vendimi. Vetë Faku-

teti i Inxhinierisë Pyjore në ato vite ishte në hapat e para, pa mbushur 20 vjet. Stacioni i Pyjeve sapo ishte krijuar e po hidhte bazat e inventarizimit e të mbarështimit të Pyjeve të lartë. Në anën tjetër, ishin vite kur pjesa më e madhe e shkencëtarëve të Pyjeve, edhe në Evropë, besonin fort tek modifikimet gjenetike apo mrekullitë e llojeve me rritje të shpejtë, si pisha radiatë, eukaliptet, plepat hibride e shume të tjera. Akoma zbulimet arkeologjike të bazuara mbi analizat e polenit e të tjera nuk kishin dhënë dëshmi për traditat e historitë e paramenaxhimit të pyllit.

Shteti e ndjeu shpejt barrën e vështirë të mbajtjes së blegtorisë. Bëri të pamundurën të mos dorëzohej, duke u futur në një rreth vicioz vendimesh të gabuara, që pasonin njëri-tjetrin, shkatërro livadhe e kullota për t'i bërë toka bujqësore, apo shpyllëzo mijëra hektarë pyje për të bërë kullota të kultivuara, ish-pyje që për shekuj i kishin realizuar njëkohësisht e vazhdonin përsëri t'i realizonin, si funksionin e pyllit (prodhimin e drurit) edhe atë të bazës ushqimore për dimër e kullotjes. Sistemi u shkatërrua në pjesën më të madhe të vendit. Furrat e centralizuara të bukës hëngrën të parat pikërisht zabelet, prozhmet, kashnjetet, ograjat e mezhdhat, pastaj fabrikat apo sistemet prodhuese komplekse të krijuara nga banorët për të prodhuar periodikisht e pandërprerje gjethë e dru për ngrohje, e kullotë poshtë tyre. Të gjithë drurët në anë të arave, livadheve, përrrenjve, mbartës të bukurive të peizazhit, biodiversitetit, por edhe nevojave të njerëzve, u prenë për të furnizuar furrat e bukës e për të mos i bërë hije tokës së bukës.

Vijon në fq. 4

Mjaft reforma me re-ndësi në sektorin e pyjeve po kryhen në një periudhë kur pyjet nuk kanë qëllimin kryesor shfrytëzimin, për plotësimin e nevojave të ekonomisë me lëndë drusore e dru zjarri, por luajnë rol shumë të rëndësishëm: "Pylli për njerëzit në zhvillimin rural, ku burimet natyrore marrin përparësi, sipas zonave ku zhvillohen". Procesi i zhvillimit të reformave këto 10 vjetët e fundit ka nxjerrë në pah përvoja tradicionale të menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve. Në zonat rurale ku njerëzit janë ndjerë përgjegjës për këto pasuri, kanë lidhur me to marrëdhëniet e zhvillimit të ekonomive të tyre. Gjatë kësaj periudhe janë identifikuar pikat e forta dhe ato të dobëta, mbi bazën e të cilave duhet të vazhdojë procesi i zhvillimit të reformave.

Përvoja e fituar

1. Objektivi kryesor ka qenë "**Puna me njerëzit e jo me pyllin**". Gjatë kësaj periudhe janë transferuar rreth 60 % e fondit pyjor e kullësor në pronësi të pushtetit vendor. Kjo do të thotë se me pyjet po merren jo vetëm strukturat e Shërbimit Pyjor, po edhe ato të NJQV-ve. Në çdo komunë ku është kryer transferimi janë ngritur Shoqata të Përdoruesve të Pyjeve Komunalë, me numër të madh anëtarësh, të cilët diskutojnë, mendojnë e kontribuojnë në menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve. Po ashtu, në çdo qark janë ngritur Federata të Pyjeve Komunalë, si koordinatorë e përfaqësues të Shoqatave, si dhe për evidentimin e problemeve dhe lobimin në plotësimin e interesave të anëtarëve. Kjo do të thotë se është rritur numri i njerëzve që mendojnë e punojnë për pyjet dhe zhvillimin rural në këto zona.

2. Çdo komunë ku është kryer transferimi ka në dispozicion një plan mbarështimi. Ky plan ndihmon stafet e komunave për të hartuar plane zhvillimi 10 vjeçare, duke i dhe-

Reformat në pyje kërkojnë mbështetje në tradita dhe në përvojën e fituar ...



në përparësi sektorit më fitimprurës nga burimet natyrore në zonën ku ata jetojnë.

3. Komisionet e fshatrave, në shumicën e rasteve janë përfshirë në procesin e transferimit, duke identifikuar përdoruesit tradicionalë, kufijtë mes fshatrave e mes përdoruesve (kjo, e veçantë sipas zonave e rretheve).

4. Aktorët vendorë po punojnë për rritjen e roleve dhe përgjegjësi në mirëmenaxhimin e pasurive natyrore. Në 40 % të pyjeve të transferuar pushtetit vendor ka përdorues tradicionalë, të cilët i kanë marrë në mbrojtje dhe kujdesin si pronarë legjitimë, pavarësisht se nuk kanë dokument zyrtar për t'u njohur si të tillë.

5. Disa komuna kanë ngritur stafet profesionale pranë administratave të tyre për zbatimin e planeve të mbarështimit, sipas kërkesave dhe afateve të përcaktuara.

6. Në nivel qarku janë kryer studimet e potencialit të arroveve, ku janë identifikuar rajonet e tyre, kapacitetet prodhuese, nevojat për zhvillim, si dhe përdoruesit tradicionalë të tyre. Në kuadër të këtyre studimeve, janë ngritur Klubet e Arroveve, si organizata përfaqësuese të grupeve të inte-

resit, ku bordet e tyre përfaqësohen me 35 % gra. Kjo tregon edhe afrimin pranë një standardi bashkëkohor të BE.

7. Në disa komuna të përzgjedhura, me mbështetjen e SNV, po behet hartografimi me pjesëmarrje, i të gjithë përdoruesve në nivel fshati, duke hartuar një plan mbarështimi për çdo grup përdoruesish apo përdorues. Sigurisht, e gjithë kjo ka ndodhur me mirëkuptimin e të gjithë komunitetit dhe strukturave të pushtetit vendor.

I gjithë ky proces reformash ka pasur si baze ligjore VKM Nr. 22, dt.09.01.2008, i cili përcakton kriteret e menaxhimit dhe rolet e aktorëve vendorë në këtë proces.

Nevojat për përmirësim

* Krahas transferimit të fondit pyjor e kullësor në pronësi të NJQV, duhet të bëheshin edhe transferimet e aseteve, burimeve njerëzore dhe atyre financiare.

* Deri në hartimin e një legjislacioni të ri për pyjet e kullotat (ose një ligji për burimet natyrore) reforma mund të shoqërohet edhe me një VKM shtesë, ku të përfshihet

roli i aktorëve të tjerë, që kanë të bëjnë me zhvillimin e kësaj reforme, si:

- Roli i Ministrisë së Brendshme, nga varen NJQV, për përgjegjësitë që kanë këto struktura në zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale;

- Roli i Ministrisë së Drejtësisë, nga varen Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (pyje e kullota) për lehtësimin dhe krijimin e kushteve për regjistrimin e kësaj pasurie në pronësi të pushtetit vendor, si dhe lehtësimin e kriterëve e procedurave për certifikimin apo regjistrimin e tyre në pronësi të përdoruesve tradicionalë;

- Roli i qarqeve në baze të detyrimeve ligjore në përcaktimin e kufijve përfundimtarë të fshatrave, si njësitë bazë nga ku do të hartohen planet për zhvillimin rural.

* Në hartën e fshatit duhet të përcaktohen qartë e me përgjegjësi të gjithë kufijtë e pronave. Të përcaktohet prona **Publike** në pronësi të Shtetit, që menaxhohet nga DSHP, prona **Komunale**, në pronësi të Komunës, që menaxhohet nga Shoqatat e Përdoruesve dhe komunitetet lokale, prona në pronësi **Tradicionale**, që menaxhohet nga përdoruesi tradicional (kërkohet njohja e pronësisë në rrugë ligjore), prona **Private**, që menaxhohet nga pronarët legjitimë. Kjo hartë, që identifikon të gjitha këto forma pronësie, të shërbejë si njësi kadastrale për zhvillimet rurale të mëtejshme (hartat e fshatrave të shërbejnë si shumatore të hartave të komunave).

* Shërbimi Pyjor të japë shembullin e mirëmenaxhimit të pyjeve në pronësi publike, të ofrojë shërbim këshillimor në

nivel komune, duke u bazuar në menaxhimin e integruar të burimeve dhe rolin shumë-funksional të burimeve natyrore e mbrojtjen e biodiversitetit. Të ngrihet një struktura në nivel qarku, që të kontrollojë e monitorojë zbatimin e legjislacionit për të gjitha format e pronësisë.

* Komunitat të hartojnë plane vjetore dhe perspektive në baze të planeve të mbarështimit ekzistues, për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore në pronësi të tyre. Ato të mbajnë përgjegjësi për mbrojtjen, ruajtjen e kësaj pasurie nga zjarret dhe dëmtimet. Në komuna të ngrihen stafet profesionale për zhvillimin dhe qeverisjen e burimeve natyrore.

* Roli i Shoqatave të Përdoruesve të Pyjeve e Kullotave në ndërgjegjësimin, sensibilizimin e komunitetit për mirëmenaxhimin e burimeve natyrore të njihet me ligj, ku të përcaktohet qartë. Po ashtu, të rritet roli i tyre në përmirësimin e të ardhurave dhe mirëqenien e komuniteteve lokale, në zhvillimin e sektorit të arroveve në tërë zinxhirin e tregut, zhvillimin e bimëve mjekësore e eterovajore.

* Roli i Federatave Rajonale të Pyjeve të përcaktohet qartë në ligj. Federatat të rrisin kapacitetet menaxhuese të shoqatave në nivel komune, për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave, të ofrojnë shërbime sipas kërkesave të tregut dhe të fermerëve, duke pasur prioritet nevojat e vetë banorëve sipas zonave ku jetojnë. Ato duhet të rrisin më shumë rolin lobues në nivel rajonal apo qendror, për përmirësimin e kuadrit ligjor apo luftën kundër dukurive negative në menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

* Në të gjitha këto procese stafet akademike të jenë të përfshira në etapat e zhvillimit të reformave, duke dhënë mendimin shkencor dhe atë profesional për zgjidhjen e problemeve teknike, duke marrë për bazë përvojat më të mira.

Për Bordin e Federatës së Pyjeve dhe Kullotave, Kukës

XHELAL SHUTI

Pylli i fermerit ka zot fermerin

Vijon nga fq. 3

Kurrë fermerët nuk i kishin kërkuar kujt, që të tufëzonin blegtorinë, apo që dikush të gatonte bukën e tyre. Ata e kishin bërë vetë mbarështimin e blegtorisë së familjes dhe gatimin e bukës që kur kishte lindur jeta. Këto tre elemente, krejt të ndërlidhur, ishin së bashku me bujqësinë, baza e zinxhirit të punësimit, edukimit e mësimin të dukurve të pyllit, duke punuar në të, furnizimit të tregut, apo qytetit, për të mundësuar me shitjen e tyre këmbimin me prodhime që vinin nga industrinë e qyteteve.

Shkolla shqiptare akoma nuk e ka vëzhguar, analizuar këtë përdorim të tokës. Opinioni publik të mirëkupton që pema frutore duhet krasitur që të prodhojë fruta, sepse shkolla bujqësore e ka mësuar e praktikuar, por nuk të kupton kur thua pylli duhet krasitur apo ricunguar për të prodhuar biomase apo dru për ngrohje, pasi shkolla pyjore akoma hesht, nuk e ka vëzhguar apo shpjeguar këtë dukuri, si dhe nuk e ka bere prone të eksperteve që ajo përgatiti. Shteti as pyeti as dëgjoi dhe kurrë nuk e kuptoi se çfarë i shkaktoi tokës dhe banorëve të vet. Pas

prerjes "së drurëve për mbarë" ish-krijuesi dhe kujdestari i fermës silvopastorale (të quajtur nga shteti pyll), nuk kish më arsye të rrinte tek koka e të priste rritjen e lastarit. Fermerit nuk i duhej me as gjeth e as kullotë. Furra e bukës hëngri çdo dru si ish-element prodhues, krijuar në shekuj nga fermeri. I gjithë territori rreth fshatit u zhvesh nga bimësia pyjore e ngjyra kafe u be dominuese. Kafshët e egra pothuaj u zhduken. Shteti tepër i zënë me ndërtime e bunkerëve në atë kohë, nuk e kuptoi marrinë që bëri.

Disa nga ish-ndërmarrjet e pyjeve, me funksion kujdesin për pyjet, u ngarkuan nga shteti të mbarështojnë blegtorit të imët. Të detyruara për të prodhuar bazë ushqimore, pa e njohur sistemin silvopastoral, ekspertet tentuan të krijojnë një model të ri prodhimi, duke vjelë vetëm gjethet e dushkut pa degë, çfarë krijonte problem, pasi gungat e drurëve të krasitur, ku mbaronte druri i vjetër dhe fillonte ai që pritej periodikisht, ishin jashtë funksioni, ndriçimi i tokës nuk realizohej si përherë e aftësia kullësore s'mund të realizohej pa praninë e dritës së diellit. Ish hapësirat

pyjore, për rreth stallave ku u përqendruan ato krijesa fatkeqe, kane mbetur toka të shkreta e akoma nuk kane arritur të rilindin vegjetacionin. Mbulesa pyjore erdhi në pakësim të menjëhershëm. E gjithë nevoja për drurin për gatim e ngrohje, iu transferua menjëherë pyllit të lartë, përgjithësisht larg fshatit, çka fermerit, i harxhonte kohën, energjinë. Te pylli i lartë malor rrebeshi i nevojave i mbeti ahut, që kurrë nuk i ishte bërë trajtim për t'u përshtatur për një funksion të tillë. I ardhur nga lashtësia pothuaj natyror, ai u gjunjësua shpejt, pa e ditur kurrë se ku po e çonin...

Si ta kthejmë fermerin tek pylli

Pylli shqiptar është në udhekryq. Shteti si shkaktar kryesor i shkatërrimit, në këtë kthesë pozitive e iniciativën e nisur në kërkim të Zotit, nuk duhet të humbasë më kohë. Kompanitë private pyjore, apo të tjera krijesa, që mund t'i paraqiten si alternativa Kryeministrit, nuk mund ta marrin pyllin shekullor të fermerit, nuk e kanë të drejtën historike, nuk e kanë dijen e as ekspertizën. Vetë këto kompani e kanë orientimin drejt pyllit të lartë malor. Ai duhet menjëherë t'i drejtohet fermerit, ashtu siç i rekomandojnë partnerët ndërkombëtarë

15 vitet e fundit, ashtu siç kërkojnë 248 shoqata të ngritura në 248 komuna të vendit e të përfaqësuar nga Federata Kombëtare e Pyjeve të Fermerëve. Pra, qeveria duhet t'i drejtohet fermerit, së pari duhet t'i kërkojë atij dhe kombit falje për dëmin që bëri shteti komunist. Të hartojë një strategji sa më të shpejtë, për të regjistruar pyllin e fermerit, të llogarisë kostot e ringritjes së sistemit prodhues sipas kërkesave të kohës, të financojë fermerët e t'i ndihmojë që të ringrenë atë që shkatërroi, të kërkojë ndihmë ndërkombëtare, në kuadër të projekteve për pagesa për shërbime mjedisore, të kërkojë që të shtohen ekspertët e pyjeve, mundësisht nga një ekspert për çdo fshat të vendit, t'i edukojë për të realizuar këtë shërbim të madh kombëtar ... Në paralel të fillojë ngritjen e agropylltarisë në zonën fushore perëndimore, si dhe në fushat e Korçës e të Devollit, për të përmirësuar tokën, për të ndihmuar bujqësinë, shtuar biomasën e ndihmuar pyllin në këtë periudhe ringritjeje. Kjo do të ishte shenja e parë që qeveria s'po bën shakanë e radhës, por po reflekton për një gabim historik, me pasojë shkatërrimin e tokës dhe varfërimin e banorëve ...

Vijon në numrin e ardhshëm....

Korresp. i "Kurora e Gjelbër"

Në pyjet e Kosovës është bërë rituali damkimi i drurëve. Çdo dru, përpara se të pritet, duhet ti nënshtrohet këtij rituali nga përfaqësuesit e institucionit të ngarkuar për këtë. Në ligjin mbi pyjet, damka është fjala kryesore. Pa damkë nuk mund të priten as drunjtë e vjetër, as ata të rinj. Vendorsët e damkës apo damkuesit, janë pylltarë, të cilët identifikohen me damkën.

Në kohën e decentralizimit të pyjeve dhe kalimit të një pjese të përgjegjësive të menaxhimit në komuna, përfaqësuesit e komunave, në emër të ruajtjes së pyjeve, kanë ngritur zërin që ta marrin damkimin nga Agjencia e Pyjeve të Kosovës. Ndërkaq, edhe zyrtarët e APK, në emër të ardhmërisë së pyjeve lobonin, që damka të mos u shpëtojë nga duart. Kjo fushatë u bë në emër të ligjit dhe pothuaj të gjithëve iu ka marrë e drejta, të mendojnë e të debatojnë, për përfitimin e pyjeve nga shoqëria dhe të shoqërisë nga pyjet, sepse në çast ta tundin ligjin "mos e shkel!"

E pse jo?! Damkuesit janë njerëz shumë të kërkuar, ata i presin të gjithë! Për shkak të përgjegjësive të mëdha që kanë, ata nuk i gjen lehtë, sepse nuk kanë kohë. Ata duhet t'i damkojnë drunjtë që duhet të priten dhe ata që duhet të transportohen?! Porositësi i damkës merr frymë i lehtësuar vetëm pasi të marrin fund këto rituale. Telashet për të kanë mbaruar dhe ai tashmë e ka fituar të drejtën ta ngrohë familjen edhe për një vit! Damkëmbajtësit, rendin

Damkosësit e pyjeve

nga NIJAZI IDRIZI

e rendin, pa pushuar, me damkën në një dorë dhe telefonin në dorën tjetër, zilja e të cilit ua merr shpirtin. Ata, do të duhej të damkosin më shumë se një milion metër kub drunj për çdo vit, aq sa është edhe potenciali i lejuar i prerjes. Por, megjithë priten plot anktë të pronarëve, kompanive, familjarëve që presin dru për të ngrohur vatrat e tyre, damkosësit, mezi arrijnë, që për një vit të damkosin 250 mijë metra kub drunj. "Aq është konsumi vjetor i familjeve tona", thotë ndonjë pylltar i zanatit, në mbrojtje të kolegëve të tij, këtë sasi e kemi djegur për ngrohje edhe sipas regjistrave të vjetër!"

Të gjithë e dinë se për konsumin vjetor të një familjeje, ka një normë, që ka dalë nga përvoja shumëvjeçare, "një metër dru, për frymë".

Për pyjet private nuk ka plane menaxhimi, sepse pronarët e tyre nuk ndihmohen që t'i hartojnë ato, me të cilin do të drejtohej damkosësi i drunjve, për ta zbatuar atë (ku duhet të pres e sa)?! Të gjithë, shfrytëzuesit e drunjve, janë të dënues me ligj, që ti presin me muaj damkuesit, për të vendosur damkën në drunjtë e tyre, ndryshe nuk mund t'i presin. Mbi 130 mijë familje (pronarë të pyjeve), në kushte normale, duhet që në fillim të vitit e deri në mars, t'i drejtohen zyrës së kadastrës nëpër komuna, për të marrë fletën poseduese, e

cila nuk thotë se sa dru ka aty, për të cilën duhet të paguajnë para?! Pastaj kërkesat duhet t'i drejtojnë në zyrat e pyjeve, herë në të Komunës e herë në të Qeverisë. As këto zyra nuk kanë regjistra të rezervave të drurëve të pronarit, që të tregojnë se çka duhet të bëhet, sepse s'ka plane. Këto zyra kanë vetëm damkën (çekiqtat). Kur t'i vije pronarit momenti fatlum, pylltari me damkën në dorë nis drejt pyllit të tij. Pylltarët janë tepër të rëndësishëm, sepse ata i presin në radhë 130 mijë pronarë, madje jo vetëm një herë?!

E pse po thonë se nuk ka vende pune?! Nëse një pronar ia merr damkosësit një ditë pune për të gjitha damkat, atëherë duhen rreth 130 mijë ditë, që ky shërbim t'u bëhet të gjithë pronarëve. Nëse i kthejmë këto ditë pune në të punësuar, numri i të papunëve në Kosovë do të bjerë. Mos harroni, kjo vlen vetëm për pyjet private, pra për më pak se gjysmën e pyjeve! Duhet edhe 60% më shumë ditë pune dhe të punësuar për damkën e drunjve në pyjet publike! Këto numra duhet t'i marrin parasysht hartuesit e strategjive, ata që planifikojnë buxhetin dhe miratuesit e ligjeve. Përndryshe, ky sektor sot, nuk ka personel, për ta realizuar damkën. Prandaj, ka dy zgjidhje: ose të parashikohet shtimi i personelit, (mbi 500 damkues me orar të plotë, vetëm për pyjet

private) ose t'i fryhet konfliktit mes pronarëve privatë dhe shtetit, në emër të zbatimit të ligjit?!

Siç e thamë, damkimi i pyjeve të 130 mijë pronarëve bëhet pa një plan të thjeshtë menaxhimi 10 vjeçar. Shteti gjatë hartimit të planeve 10 vjeçare të menaxhimit për pyjet publike, i ka hequr nga regjistrat sipërfaqet e pyjeve private. Kjo heqje, madje ka pasur një kosto buxhetore?! Askush nuk ka menduar që të provojë ta arrijë një marrëveshje me pronarët e pyjeve, që në vend të pagesës për fletët poseduese (të cilat në të vërtetë, nuk thonë gjë), të paguajnë (më shumë për simbolikë), për këto plane. Ky aktivitet nuk do të ishte vetëm plan, por do të ishte një marrëveshje e çdo pronari me ekspertët e pylltarisë dhe me vet ligjin. Kjo marrëveshje do të vendoste ekuilibër në pronën, drunjtë që rriten aty, perspektiven e tyre dhe dëshirën e pronarit. Për më shumë, ky plan, do të ishte një kontratë mirëbesimi midis pyllit, ligjit dhe popullit, që secili të japë kontributin e vet, në mënyrën më të mirë. Shteti bën ligje dhe kontrollon zbatimin e tyre, profesionistët e bëjnë të dobishme dijen e tyre dhe pronarit i hapet rruga për ta rritur vlerën e pronës së tij, që është pronë dhe pasuri e gjithë vendit.

Kjo kontratë shoqërore do t'i çlironte të gjitha palët nga akuzat reciproke, për vjedhje/hajni në

pyje. Qeveria nuk do t'i akuzojë rreth dhjetë mijë qytetarë në vit, se marrin ilegalisht mbi 700 mijë metra kub dru nga pylli, qytetarët nuk do t'i akuzojnë pylltarët për korrupsion dhe për shkatërrim të pasurisë me të madhe të kombit e, së fundi, gjyqtarët do të kishin më pak punë!

Kjo nuk mund të arrihet me fjalë, apo vetëm me media, por me sisteme, siç e ka çdo vend evropian. Është e sigurt se kjo nuk mund të bëhet shpejt, pasi duhet të bëhet duke identifikuar çdo pronar dhe duke e "legalizuar" pyllin e tij.

Kur dhe sa duhet të priten pyjet për ngrohjen e familjeve e cakton eksperti i pyjeve. Këtu nuk duhet të ngatërrohet as politika as ligjëbërësit. Pronarit nuk guxon t'i shkelet e drejta e pronës dhe e përfitimit nga ajo. Ndryshe, nëse kjo ndodh, shteti duhet t'i kompensojë ata! Çdo pronar e di se kur pylli i tij duhet të pritet. Nëse kësaj nuk i beson shteti, duhet të dërgojë ekspertin, jo për ta dënues atë, por që së bashku ta bëjnë vlerësimin. Pronari dhe shteti duhet t'i zbatojnë kushtet, për të cilat janë marrëveshje. Kjo qasje e re, do kohë që të akceptohet, por ajo duhet të ketë vendin e vet në ligjin e ri mbi pyjet e Kosovës.

Njerëzit janë lodhur nga skenat e hajnive në pyje. Po akuzohet për hajni dhe shkelje të ligjit, qytetari i Kosovës i cili pyllin mund ta ketë pasuri të vetme?!

Shoqatat e Pronarëve të Pyjeve Private të Kosovës—në ndërrim të viteve

Vijon nga fq. 1



shtetje të donatorëve, FAO e SORROS, u krijua shoqata e parë kombëtare, e cila sot është prijëse e 16 shoqatave komunale të themeluara në Pejë, Ferizaj e Prizren.

Rruga që kanë filluar pronarët e pyjeve për t'u organizuar në shoqata, duket si shpresë për të gjithë ata që me shekuj janë adhurues të pyjeve, natyrës dhe vendit ku jetojnë. Me vite të tëra pronarët kanë shpresuar në ditën kur do të mund jenë zot të pronës së tyre, të lënë nga gjyshërit e për t'i pasuar edhe më të bukura tek nipërit. Andaj iniciativa për t'u bashkuar në shoqatë, me qëllim mbrojtjen dhe menaxhimin më të mirë të pyjeve, atyre u duk një hap i goditur dhe shpresë e mirë për të ardhmen e pyjeve e posaçërisht atyre që jetojnë pranë pyjeve.

Atë ditë të gjithë përfaqësuesit e shoqatave, të përgatitur në mënyrë të denjë, prezantuan punën e kryer që nga themelimi, funksionimin, aktivitetet dhe

planin e punës për të ardhmen. Nga prezantimet dukej qartë se të gjithë kishin të njëjtin synim "t'i mbrojmë e menaxhojmë pyjet si na i kanë lënë të parët", kurse ajo çka i brengos shumicën prej tyre është çështja e pronësisë, të cilën po e shohin si peng të së drejtës nga vitet e kaluara. Sot ata ndihen më krenarë ngase të bashkuar do të mund të ngrenë zërin për të ndritur ballin e të parëve dhe hequr petkun e zi të dimrit të gjatë shekullor. Por, për gjithë punën dhe të arriturat, shoqatat falënderojnë e vlerësojnë ata që fillimisht u hapen dyert e rrugëtimit, gjithë atyre që shprehën vullnetin dhe përkrahjen iniciativën e pronarëve për t'u bashkuar dhe gjithë atyre që do t'u qëndrojnë pranë në rrugëtimitin e gjatë, të cilin vetëm sa e kanë filluar.

Shoqata e pronarëve të Pejës ka dy angazhime si të veçanta, atë të studimit për të përdorur mbetjet e pyllit për bioenergji,



si dhe studimin për kontekstet pronësore në Luginën e Rugovës. Përndryshe, shoqata e Novobërdës sheh si sfidë krye-



sore regjistrin me gjithë të dhënat bazë të anëtarëve në shkallë komunale. Shoqatat e Suharekës dhe Junikut sjellin një përvojë të re, punën me fëmijët e pronarëve, për të shtuar dijet për pyllin privat, duke premtuar për vitin 2012 një libër të mrekullueshëm për të njohur pyllin dhe elementet e planeve të thjeshta menaxhuese.

Pronarët po kontribuojnë për studime të detajuara të mënyrës së rritjes së drurit, duke kontribuar në pasurimin e metodave silvikulturore. Duke ballafaquar nevojat e pronarëve me potencialin e pyllit që disponojnë, ata propozojnë trajtime e prerje të qëndrueshme.

Ajo çka u shton vlerën qyteteve të Kosovës është

kultura dhe historia e popullit, e cila gjithmonë ka një rrëfim sa të vuajtur edhe krenar, për token, bjeshkën dhe malet.

Çështja e pronësisë nuk ishte e vetmja që theksohej në prezantimet e shoqatave. Kjo ishte pikërisht ajo temë që ndërli dhej me ligjin e pyjeve,

duhet ngulitur në mendjen e të gjithëve, duke filluar nga niveli qendror e deri tek strukturat komunale. Pyllin tim e shfrytëzoj për nevojat familjare dhe s'kam nga t'ia mbaj, e për këtë unë duhet të paguaj shtrenjtë me kohën dhe koston, thotë një pronar privat kur po flitej për ligjin dhe zbatimin e tij.



për çka shoqatat janë të angazhuara dhe nën ombrellën e shoqatës kombëtare janë edhe pjesë e grupit punues për hartimin e ligjit të ri për pyjet. "Athua, vallë, do t'i marrë dikush parasysht këto çka ne rekomandojmë"? Kjo ishte ajo çka vazhdimisht pronarët shprehnin kur flitej për ligjin. Ata luftojnë për të drejtën e tyre dhe të pyjeve. Duket sikur janë lënë pas dore me vite të tëra kur bëhet fjalë për zbatimin e së drejtës apo ligjit! Ajo çka më shumë i vret është se ata duhet të kalojnë nëpër procedura të stërzgjatura e burokratike për të shfrytëzuar masën drunore që kanë në pyllin e tyre. A s'është kjo diçka që duhet luftuar për të ardhmen, diçka që

Të gjitha këto janë çështje që prekin pronarët e pyjeve dhe për të cilat duhen angazhuar të gjithë e në veçanti shoqatat me përfaqësim të gjithë komunitetit për çka edhe janë bashkuar sot dhe do vazhdojnë edhe nesër, duke u zgjeruar edhe nëpër komuna e tjera të Kosovës. Por, një gjë është e sigurt, ata i pret një sfidë e madhe dhe do përballen me një sërë vështirësish, ama gjithë kohën do t'i përcjellë amaneti i të parëve. Ata do të jenë udhërrëfyes të trashëgimtarëve të rinj dhe do të jenë prijës të së ardhmes së pyjeve, me synim ruajtjen, sigurimin e të ardhurave dhe përmirësimin e shërbimeve mjedisore e sociale.

Druri, mrekulli natyrore

nga MIFTAR LOKAJ

Druri është përfaqësuesi më i përhapur i florës sonë tokësore, që nga e kaluara shumë e largët në formën e fierëve të drunjtë. Gjatë etapave gjeologjike, në ndikimin e kushteve të ndryshme klimatike janë zhvilluar shumë familje e specie drurësh. Druri, si material, prej të cilit diçka prodhohet, është produkt i organizmit të gjallë, pemës (trungut) së pyllit. Kur themi: prodhimi është organizëm i gjallë, prodhim prej diçkaje që lind, rritet e zhvillohet dhe vdes, a thua nuk nxit një frikë dhe respekt! Çfarë raporti ka njeriu ndaj atij trunq, kur trunq ka humbur (ose ne njerëzit ia kemi marrë!) funksionet e jetës?! Për shkak të mbijetesës në kushte të rënda, njeriu e ka përdorur drurin për ndërtim strehimoresh, të cilat e kanë mbrojtur nga ndikimet natyrore dhe rreziqet e ndryshme të botës shtazore.



Deban druri



Si mjete pune dhe armë. Si zbulim epokal, druri është përdorur për lëndë djegëse nga njerëzit e parë dhe është ende burimi primar i energjisë ngrohëse më të madhe të botës. Druri është përdorur dhe akoma përdoret si lëndë djegëse për gatim. Për të gjitha këto dhe përdorime të ngja-

shme, druri në fillim është përdorur i pa ose me një përpunim minimal. Në një shkallë më të lartë të zhvillimit të vet, njeriu, i vetëdijshëm për cilësitë dhe vlerat e drurit, pret e sharron pemën (lisin) dhe shfrytëzon pjesët e saj për të përmirësuar kushtet e veta të jetës. U vuri zjarrin sipërfaqeve të mëdha të pyjeve dhe i transformoi në sipërfaqe të punueshme bujqësore. Pyje ka me bollëk dhe njeriu i preokupuar me veten nuk mendon (për vedit) për të ardhmen e largët dhe mundësinë e shkatërrimit të pyjeve dhe shfarosjen e tyre si dhe humbjen e burimit të atij materiali të dashur e të vlefshëm për njeriun - drurit. Është interesant edhe për ne sot se si njeriu ka ditur ta vlerësojë drurin deri edhe për zbulim, duke i dhënë forma artistike drurit dhe prodhimeve të tij.



Çarshi druri, Gjakovë

Të kujtojmë monumente qetësuese (edhe pse relativisht të përmasave të vogla) sarkofagët egjiptianë të drurit, si dhe dhëniën e formave të ndryshme artistike në anijet vitale e të pabesueshme, aq elegante, nga njëherë me kokat e tyre frikësuese në pjesën vazhduese të përparme. Punimet e shumta prej druri për gjueti dhe peshkim, për ecje nëpër borë, etj. Kush mund të mbetet i ftoftë para konstruksioneve të arkitekturës askete, kishave në Norvegji, të vjetra disa qindra vjet, të nderuara nga pemët dhe dërrasat e pishave dhe hormoqit, kabanat e të cilave simbolikisht ngrihen drejt qiellit.

Tek ne druri si materiali më i vjetër është përdorur nga kohët e lashta

për ndërtimin e kasolleve, debaneve, shtëpive, ndërtesave dhe objekteve të ndërtuara, siç janë xhamitë, kishat, katedralet, mullinjtë, urat, çatia e Kalasë "Rozafa", Shkodër, brendia e mullirit të Haxhi Zekës në Pejë, Hani i Haraçive në Gjakovë, etj.



Mjete druri për të përpunuar qumështin

Po ashtu druri është përdorur shumë herët si enë se bashku me enët argjilore në kuzhinat e stërgjyshërve tanë, për ruajtjen e përpunimit të drurit masiv (teknologjisë së sharrave). Me frikësim, respekt e njohuri duhet t'i qasemi vendimit për të ndaluar jetën e një druri 100 vjeçar, sepse të mos harrojmë se kemi të bëjmë me aktin e konvertimit të organizmit të gjallë, pemës, por edhe të drurit të rrumbullakët, në një mall për shoqërinë. Sa akt i ndërjegjshëm? A e bëjmë këtë vërtetë me përgjegjësi çdo herë? Me përgjegjësi ndaj natyrës dhe vetes sonë ...



Trung hormoqi rreth 100 vjeçar, Rugovë

Njeriu të gjitha këto produkte i ka punuar prej llojeve të ndryshme të drurit të haloreve, siç janë hartina, rrobulli, arneni, bredhi, hormoqi, ndërsa prej llojeve të fletoreve gështenja, bunga, panja, frashri dhe drurë të tjerë nga specie të tjera që kanë ngjyra, tekstura, dendësi dhe karakteristika të ndryshme dhe të pasura. Pra, vetitë e jashtëzakonshme që ka druri kundrejt elementeve të tjerë, siç janë qëndrueshmëria dhe siguria sizmike, higjiena dhe mjedisi më i shëndetshëm e komod, prevalenca në ruajtjen e energjisë dhe lehtësia e ngrohjes, duke siguruar rritjen e sigurisë në rast zjarri, estetika, izolim i mirë termik, vetitë elektrike dhe akustike si dhe si një material termoizolues ndaj lagështirës, duke absorbuar ndryshimet në lagështi, e bëjnë lëndën e drurit që edhe sot të jetë në avantazh për përdorim. Pa prodhime druri, siç janë celuloza, nuk mund të paramendohet prodhimi i letrës.

E kështu do të mund të vazhdonim me numërimin me shembuj

nëpër anët e ndryshme të botës mbi shfrytëzimin e drurit në historinë e njerëzimit, jo vetëm si material i jashtëzakonshëm për plotësimin e nevojave më të llojllojshme, por edhe për nevojën e shprehjes shpirtërore për garë me të bukurën.



Djepe prej dru ahu

Nisur nga rëndësia e madhe e drurit, vëmendja duhet përqendruar në parimet e arritjes sa më të mirë sasiore dhe cilësore të shfrytëzimit të asortimenteve të drurit, nëpërmjet teknologjive moderne të përpunimit të drurit masiv (teknologjisë së sharrave). Me frikësim, respekt e njohuri duhet t'i qasemi vendimit për të ndaluar jetën e një druri 100 vjeçar, sepse të mos harrojmë se kemi të bëjmë me aktin e konvertimit të organizmit të gjallë, pemës, por edhe të drurit të rrumbullakët, në një mall për shoqërinë. Sa akt i ndërjegjshëm? A e bëjmë këtë vërtetë me përgjegjësi çdo herë? Me përgjegjësi ndaj natyrës dhe vetes sonë ...



Dru të çara ahu

Prandaj, që të jemi në gjendje ta kryejmë me sukses aktin e sharrimit të drurëve të rrumbullakët dhe sharrimin e mëvonshëm të dërrasave të prodhuara, na nevojitet që para se gjithash të armatosemi me dije. Kur flasim për mënyrën e sharrimit gjithsesi kemi nder mend llojet e makinave primare e sekondare, me të cilat behet sharrimi primar i drurit të rrumbullakët dhe sharrimi i produkteve të sharruara në pjese të tjera të destinuar për prodhime finale të drurit.

Çështje me rëndësi është shfrytëzimi i drurit në formën finale të tij. Druri është pra një material shumë i çmuar. Me vlera komparative të drurit kuptojmë vetitë estetike të drurit (ngjyra, tekstura, por edhe "gabime" të drurit), ngrohtësinë e tij në kontakt me njeriun, mundësinë e dhënies se formës dhe përpunimit në përgjithësi. Në këtë kuptim, druri masiv në të ardhmen do të shfrytëzohet para se gjithash aty ku vjen në kontakt direkt e indirekte me njeriun.



Veku për prodhim qilimash

Prandaj, drurin do të duhej ta shfrytëzonim sidomos për prodhimin e mobilieve, për përpunimin e dyerve dhe dritareve, për punimin e shtëpizave prej druri, për rregullimin e brendshëm të banesave (veshje muresh, shkallë të ndryshme), për prodhimin e parketit dhe dysheve. Po ashtu, druri është material i pazëvendësueshëm për prodhimin e instrumenteve muzikore (vetitë akustike të drurit). Teknologjia moderne e ngjitjes së drurit mundëson edhe përdorimin e suksesshëm për projektme arkitekturale të mbajtëseve me dis-

tancë të madhe (për mjedise sportive, hapësira të mbyllura për pishina, si dhe për qëllime të tjera).

Trajuam shkurt disa nga cilësitë, vlerat dhe përdorimet, për të cilat mund të shkruhen faqe të tëra. Por, edhe nga këto pak shembuj që sollëm, del qartë se druri është një mrekulli që natyra bujare i ka "dhuruar" njeriut. Atëherë, edhe ne duhet ta kemi obligim që të kujdesemi për pyllin, ku rriten drurët, që na bëjnë gjithë këto shërbime.



Restorant druri Skukeza, Gjakovë



ALCDF

(ALBANIAN LOCAL CAPACITY DEVELOPMENT FOUNDATION)

Thirrje për Aplikime:

Fondacioni ALCDF, në kuadër të Fondit Partneritete për Inovacion (P4I), hap Raundin e 5 (pestë) të aplikimeve për te gjithë aktorët ruralë të formalizuar (individë me NIPT, OJF, kompani në pronësi të shtetasve shqiptarë dhe autoritetet / organizmat / institucionet e qeverisjes vendore) në rajonet Korçë, Dibër, Elbasan, Tiranë, Kukës, Shkodër e Gjirokastrë.

Aplikantët duhet të paraqesin kërkesat për Shërbime në fushën e Zhvillimit të kapaciteteve. Kërkesat duhet të jenë të fokusuar në sektorët e pyjeve, bujqësisë, turizmit dhe qeverisjes lokale.

Aplikantët (shërbimkërkuesit) e interesuar mund të vizitojnë web portalin tonë www.alcdf.org ku jepet informacion i duhur për kriteret, formatin dhe mënyrën e aplikimit, afatet kohore, etj.

Afati i pranimit të aplikimeve do të jetë deri me 20 prill 2012, ora 17:00. Për më shumë informacion mund të kontaktoni:

- në Korçë, Vangjush Dishnica, vangjushdishnica@yahoo.com
- në Elbasan Hasan Drazhi, hdrazhi@yahoo.com
- në Dibër, Zenulla Mehmeti, mehmeti68@yahoo.com
- në Tiranë, Lorena Totoni, loar@abissnet.al
- në Shkodër, Merita Kazazi, adavila12003@yahoo.it
- në Kukës, Shkëlqim Kastrati, shkelqim_ka@hotmail.com
- në Gjirokastrë, Kristofor Muka, mkrstofor@yahoo.com

Aplikimet mund të dorëzohen online nëpërmjet portalit www.PrexAlbania.com, si dhe dorazi pranë zyrave të ALCDF me adresë: Rr. Pjetër Bogdani, 23/1, Tiranë, Albania, ose pranë personave të kontaktit në rajonet përkatëse në zyrat e Këshillit të Qarkut.

Për më shumë informacion mund të kontaktoni me Z. Besnik Alku, menaxher i Fondit P4I me E-mail: balku@alcdf.org

mobil: 067 20 89 376 ose Tel: 04 224 07 51

Magjia e natyrës dhe bota virtuale

nga **LUAN AHMETAJ**

Deja për të bërë këtë shkrim më erdhi krejt rastësisht, pasi këto ditë përjetova një pamje të veçantë në një nga lagjet e kryeqytetit ku unë jetoj dhe punoj. Në tarracën e një pallati të ri të mbuluar nga antenat dhe depozitat e shumta të ujit, vura re dy fëmijë që përiqeshin të ndërtonin një kafaz pëllumbash, të cilët, në shenjë mirënjohje, duke se luanin me ta miqësisht, duke fluturuar dhe hipur mbi supet e tyre të vegjël. Ndërkohë, mund të konstatohej lehtë se kati i parë i këtij pallati ishte plot me dyqane. Në fillim ishte një butik, që pasohej nga një bar-kafe. Më tej një pikë interneti mbushur në të dy krahët me tavolina kompjuterash dhe, krahas saj, një dyqan bastesh sportive. Në atë çast, në butik nuk pashë njeri tjetër, përveç një vaje të re e simpatike, që sillej vërdallë duke u rregulluar jakat e kostumeve manekinëve të vendosur në vitrinë e që duhet të ishte shitësjë e dyqanit. Në bar kishte disa persona në moshë të rritur, të cilët, duke tymosur ndonjë cigare, rruftin filxhanët e tyre të kafesë. Ndërsa në lojalet e internetit dhe të basteve sportive kishte me shumë njerëz, shumica e të cilëve ishin të rinj. Të përkulur para kompjuterave, disa prej tyre lundronin në internet, ndërsa pjesa tjetër me sytë e ngulitur tek ekrani i televizorit, plotësonin ndonjë skedë bastesh me shpresën se fati mund t'i bënte ata milionerë. Ndaj, në këtë shkrim do të përiqem të jap disa konsiderata rreth raporteve që krijohen midis natyrës, njerëzve dhe jetës së tyre virtuale.

Qytetet dhe fshatrat e të gjithë botës janë krijuar në kohë të caktuar dhe në një mjedis të caktuar natyror me karakteristikë të veçanta të gjeologjisë, burimeve ujore, klimës, peizazhit dhe biodiversitetit. Jeta njerëzore është e lidhur me natyrën dhe njerëzit kanë nevojë të jenë në kontakt e ndërveprim të pandërprerë me të në dobi të mirëqenies së tyre.

Natyrë përfshin biodiversitetin, peizazhin, ujin, tokën, fushat, malet, kodrat, pyjet, lagunat, detet, liqenet,

lumenjtë, diellin, dritën, bimët, kafshët, shpezët, gjallesat, lulet, ujëvarat, shkëmbinjë, mineralet, rërën, ajrin, shiun, erën, akullin, borën etj. Natyra jonë e mrekullueshme na ka dhënë ne shqiptarëve privilegjin që të kemi burime të shumta ujore dhe minerale, biodiversitet të pasur, peizazh të bukur e të larmishëm dhe një klimë të moderuar. Pasuria e burimeve natyrore të tokës dhe nëntokës sonë i shërben zhvillimit ekonomik të vendit, ndërsa klima mjaft e përshtatshme dhe peizazhi ynë i mrekullueshëm i shërben zhvillimit të turizmit në të gjithë territorin dhe përgjatë gjithë vitit. Përditë dhe në çdo kohë ne kemi mundësinë t'i shijojmë këto magji të natyrës sonë të rrallë. Kjo bën që t'u drejtohem bukuri të pafund që shfaqen përgjatë gjithë territorit tonë, që nga riviera e mrekullueshme me brigjet e thyer, ku valët e detit diku përplasen fort e thyhen në shkëmbinjë e mëdhenj dhe diku shtrihen e treten në rërën e nxehtë, deri në majat e maleve tanë të lartë e përherë të gjelbëruar, të cilët gjatë dimrit mbulohej me pëlurë e bardhë e gjigante të borës. Gjatë verës një pjesë e njerëzve apo turistëve të huaj u drejtohet brigjeve të deteve e liqeneve tona për të shijuar freskinë e plazheve tanë të virgjër nën shoqërinë e njerëzve dhe miqve të tyre të afërt, si dhe për të shijuar ushqimin e shijshëm dhe gatimin tradicional të bregdetasve tanë, duke vështruar se si piqet qengji në hell apo peshku në zagarë nën atmosferën e pakrahasueshme shpirtërore që të krijon kënga labe dhe humori i hollë i atyre njerëzve të qeshur e bujarë. Ndërsa një pjesë tjetër u drejtohet maleve tanë të lartë e të thepisur, trupi i të cilëve përshkohet nga lumenj gjarpërorsh dhe të zhurmshëm e nga ujëvara shkumëzuese e mjaft piktoreske. Ata shkojnë për të shijuar bukuritë

e papërsëritshme që ato ofrojnë, si dhe për të thithur ajrin e pastër që lëshojnë pyjet e atyre zonave. Shkojnë gjithashtu për t'u relaksuar nga freskia ledhatuese, aroma dehëse dhe filladi përkëdhelës që lëshojnë këto vise përgjatë mëngjesëve apo mbrëmjeve verore. Kurse gjatë dimrit një pjesë e njerëzve u ngjiten maleve të veshur me borë për të marrë kënaqësinë e veçantë që të jep sporti i bukur i skive, ndërsa një pjesë tjetër për të provuar mikpritjen e atyre anëve nën avujt e ngrohtë që lëshojnë oxhaqet e kullave të malësorëve tanë nën tingujt e ëmbël të lahutës dhe interpretimin virtuoz të rapsodëve të talentuar. Shumë të tjerë qëndrojnë në qytetet dhe shtëpitë e tyre duke u mjaftuar me bukuritë e parqeve dhe lulishteve që janë ndërtuar si oaze të gjelbër e të lulëzuar në mes të trupit gjigant të të gurtë të qyteteve tona.

Por jeta është shumë më shumë se kaq. Në përgjithësi ajo është e mbushur plot me zhvillime, ndryshime, risi, liri, mundësi, punësim, shkollim, politikë, biznes, sukses, dështim, krizë, debat, luftë, paqe, dashuri, urrejtje, lindje, vdekje, solidaritet, tradhti, kënaqësi, sport, art, dëshpërim, gëzim, hidhërim, shpresë, iluzion, optimizëm, pesimizëm, argëtim, komunikim, ushqim, drogë, seks, zhurmë etj. Dhe çdo njeri ka të drejtë ta ndërtojë dhe gëzojë jetën e tij private, familjare apo shoqërore në përputhje me dëshirat dhe mundësitë e veta si dhe me rregullat apo ligjësitë që përcakton jeta në komunitet. Cilësia e jetës është e lidhur pazgjidhshëmrisht me zhvillimin ekonomik, shoqëror, social e kulturor të vet familjes, krahinës apo vendit në përgjithësi si dhe me burimet dhe pasuritë natyrore që ata posedojnë dhe administrojnë.

Por një ndikim shumë të fuqishëm në mënyrën dhe stilin e jetës ka urbanizimi mjaft i shpejtë dhe i gjërë dhe përhapja me shpejtësinë

e erës e teknologjisë elektronike dhe digjitale, televizionit, kompjuterit dhe celularit, qysh nga format e tyre më të thjeshta deri në ato më modernet. Edhe në vendin tonë lëvizja e lirë e njerëzve ndër këto vite demokracie, braktisja e zonave rurale dhe mbipopullimi i zonave urbane ka sjellë ndryshime të mëdha jo vetëm në zhvillimin dhe menaxhimin e mjedisit urban, por edhe në mënyrën e jetesës dhe cilësinë e jetës. Këto kanë të bëjnë jo vetëm me ndryshimin e hapësirave urbane, me punësimin, me shkollimin, me të ardhurat, me zakonet e traditat e tyre por edhe me integrimin social, ekonomik e kulturor të kategorisë së këtyre njerëzve, të vendosur tashmë në mjedise të reja, në kushte të tjera dhe në bashkëjetesë të re me banorët e mëhershëm të qyteteve tona.

Po ashtu zhvillimi i teknologjisë, futja në mënyrë të shpejtë dhe masive e internetit, kompjuterit dhe celularit ka një efekt të jashtëzakonshëm në jetën e gjithë njerëzimit dhe në mbarë rruzullin. Padyshim, kjo përbën një arritje të madhe të shkencës dhe teknikës në drejtim të përmirësimit të shpejtësisë së përhapjes së informacionit dhe të komunikimit si dhe të ruajtjes të të dhënave, duke sjellë edhe mjaft ndryshime në mënyrën dhe stilin e jetës së njerëzve të të gjitha moshave, racave dhe kombësive. Porse, nga ana tjetër, ato kanë bërë që njeriu i sotëm të bëjë një jetë më virtuale, që ai të ngulitet përditë e më shumë e për orë të tëra përpara ekraneve të televizorit, kompjuterit apo celularit duke u zhytur në një botë virtuale. Sot edhe bebet e porsardhur në jetë në një kohë mjaft të shpejtë gjenden përpara ekraneve të televizorit apo me një aparat celulari në dorë duke luajtur. Fëmijë ende në moshë të vogël i drejtohen ekraneve të televizorit apo kompjuterit duke parë filma pafund. Nxënësit e shkollës



braktisin mësimet dhe librat të rrëmbyer për orë të tëra nga interneti apo facebooku. Gratë, qofshin shtëpiake apo intelektuale, gjithnjë e më shumë janë të tërhequra nga telenovelat e stërgjata televizive. Burrat që gjer me sot s'kanë lënë debat politik pa ndjekur në televizor, tashmë kanë filluar të frekuentojnë mjaft shpesh edhe sallonet e basteve sportive. Këta njerëz të të gjitha moshave, kategorive e sekseve janë bërë më të varur nga kjo botë virtuale e cila ka ndikuar jo pak negativisht në cilësinë e vet jetës së tyre, në shëndetin, edukimin, mbarëvajtjen dhe mirëqenien e tyre.

Pikërisht kjo e bën akoma më të domosdoshme që njerëzit të kenë kontakt të vazhdueshëm me natyrën, me biodiversitetin, me bukuritë natyrore të vendit të tyre. Të vlerësojnë, të ruajnë, të respektojnë, të shtojnë dhe të rigjenerojnë vazhdimisht këto vlera të natyrës dhe të mjedisit urban. Të frekuentojnë sa më shpesh natyrën, detin, liqenet, malet, pyjet, parqet, lulishtet, kopshtet botanike dhe zoologjike si dhe qendrat e tjera rekreative që janë ndërtuar brenda dhe jashtë qyteteve ku ata jetojnë dhe punojnë. Vetëm kështu çdonjëri prej nesh dhe të gjithë ne do të ndihemi përherë e më mirë, më të qetë, më të paqetë dhe më të shëndetshëm.



NJOFTIM

Fidanishtja e Kurtish Dafkut në Komunën TopoJan të Kukësit, disponon fidanë:

- | | |
|---------------------------------|--------------------|
| 1. Mështekne (dyvjeçarë) | copë 30 000 |
| 2. Pishe (dyvjeçarë) | copë 10 000 |

Për më tepër informacion, kontaktoni:

Kurtish DAFKU cel: 068 62 75 433; 067 20 37 565

Kudo stres

Stres në qytet të jesh, stres në fshat të shkosh.
Kudo njësoj është. Tmerr do të shikosh.
Stres kur vjen nata dhe ëndrra shikon.
Stres dhe kur vjen dita dhe ulërimë dëgjon.

Vallë do vijë dita, që pa stres të jesh?
Kjo të jep shpresë. Të pëlqen të flesh.
Stres kur vjen dreka, dhe nuk ke ç'të hash.
Stres kur qan fëmija, dhe ty të bën të qash.

Stresin e ndjen në rrugë, nga makinat që ngasin.
Stres kur dëgjon boritë, që si qen ulërasin.
Stres të dalësh jashtë, stres të hysh brenda.
Stres në çdo kohë. Një stres që s'ta ka ënda.

Stres kur shkon, kërkon dhe punë nuk gjen.
Stres dhe kur mendon: - Ç'dit' e keqe vjen!
Stres kur je në gjumë, stres dhe kur nuk fle.
Stres dhe kur del jashtë dhe çfarë nuk sheh.

Stres kur në pazar, shkon për të blerë.
Stres dhe kur mendon: - Çmimi a do bjerë?
Stres kur sheh ministra, që në ekran dalin,
qeshin me fukaranë dhe shpresë s'të ngjallin.

Shpëtim Myrto



Stres kur duam bollëk, por pa punuar kurrë.
Stres, kur nga skamja, të digjet koka furrë.
Stres kur në spital shkon, se duhen para shumë.
Stres dhe në farmaci, me çmimet në hava.

Kur shkon te firma "GABI", të sjell veç neveri.
aty, ku gjithë zhelet e botës, i gjen pa kufi.
Stres kur shkon në shkollë dhe drogë shikon,
Stres kur pas një stresi, ulesh të pushosh.

Stres kur dëgjon radio dhe televizion shikon.
Stres kur humb gomonia dhe lemeri dëgjon.
Stres kur shkon rrugës dhe plehra shikon.
Stres kur aromën e tyre, me neveri shijon.

Stres kur i flet tjetrit: - Mos se s'ka lezet!
Stres kur të përgjigjet: - Kot e ke që flet!

Stres kur sheh bagëti që në rrugë theren.
Stres kur sheh kasapët, që me pisllek merren.

Stres kur presin mishin me pisllek gatuar,
Stres kur s'kanë turp, me të palarat duar.
Stres kur shesin qumësht, me shishet pa larë,
të vjen për të nxjerrë, të vjen për të qarë.

Stres kur djath' e gjizë, sheh që tregtojnë,
dhe kur sheh mizat, që mbi të qëndrojnë.
Stres kur bie shi, dhe ujë e drita s'ka,
jeta të pështiroset, sikur je në Sahara.

Stres kur bie shi dhe rrugët mbushen plot.
Stres kur të mbyt pislleku dhe ti qan me lot.
Stresi është i madh kur ujërat përzihen,
Kur të zeza e të bardha, mbi trotuar shihen.

Stres kur sheh makinat me dru ngarkuar,
dhe kur mendon se pyjet krejt janë mbaruar.
Stres kur sheh dhe pishën, që digjet ne furrë,
dhe ti belbezon: - Ditë, mos u kujtofosh kurrë!

Stres kur sheh makinat me gurë ngarkuar,
dhe të kujtohet mali me zhele arnuar.
Stres për Krastë - Krujën, dikur plot blerim,
sot s'ka asnjë pemë, s'ka as gjelbërim.

Stres kur pritet pylli dhe kur digjet guri,
kur të gjithë qytetin, mbyt tymi dhe pluhuri.
Stres kur shikon tokën ugar dhe pa punuar,
ose kur sheh rininë pa qethur e pa rruar.

Stres kur sheh fshatarin, me gomar dhe kalë,
lëvtron me parmendë, si dikur më parë.
Stres kur ndërton sot, dhe e prish mot,
Dhe kur shikon se ligji, nuk i del përzot.

Pse mor vendi im, veç tek ty ka stres?
Kur do vijë dita, të rrimë serbes?
Kur do vijë dita të jetojmë të qetë,
ashtu si gjithë bota, ashtu si ka lezet.

Kur do punojmë për vete, me orar të gjatë,
dhe të vijë dita, mos shkojmë refugjatë?
Kur do kemi ujë dhe drita me bollëk,
dhe të heqim dorë nga puna plot pisllek?

Kur do i shohim rrugët pa gropa e shtruar,
dhe tokat e fshatit, me traktor punuar?
Kur s'do priten pyjet, njëher' e përgjithmonë,
Që t'i kemi për vete dhe për ata që vijnë më vonë?

Shpëtim Myrto, inxhinieri i talentuar, që tërë jetën punon për pyjet... me dashuri e përkushtim të jashtëzakonshëm...

Farmer's forest owner is farmer

(Any attempt to continue keeping his pledge to the forest would mean a continuation of destruction)



The farmer-forest is an ancient silvo pastoral system

Trees that nature has bestowed our land, are many and hard to learn to cohabit with aggressiveness of Mediterranean human. They came in our earth millions of years before us. Then came people. They just raised their settlements beam trees, mainly oaks, but in certain circumstances with others. Ancient people worked to adapted trees as well as domesticated animals. Locals, perhaps the authors of this adoption, quickly learned the secret of making concessions that nature, and began by country of natural resources that they possessed, to be adjusted. Step by step they learned that shoots emerging from stumps to leave to grow up in that dimension, that they had, dividing the forest in part, to have to cut and left to raise, as well as pasture or things shared basic existence.

The miracle lies in the fact that the roots of these trees, or more precisely these kinds of forest wood components are almost all those who have populated our land from the beginning, that are natural and native species, offspring of the virgin forest, which pointed treatment primitive man. This forest is an essential difference from state forests has made, for example pine, acacia and poplar, because in these cases is the plant and is forced to grow a forest type that has not been before the country, as for example, corn is planted or potatoes, which are coming from other continents.

These systems were adopted, in accordance with the circum-

stances of the residence, as simple to manufacture wood material, with rotations, the amount of the desired dimensions, and by combining wood production, the food base for livestock grazing. These management systems have reached up to nowadays. Looks like detail explanation, but the confusion and lack of understanding by policy makers necessitates telling these details, not so desirable, often strongly criticized as slaughter, by the administration and forestry experts. This system manufacturer, for rural dwellers, like a simple factory that spends time getting up and then produces consistently. It was a very flexible project, that every family, and adopt easy, trying every year to work in a territory why (often a third), which was accepted by fellow neighbors, where according circumstances had put the borders, who today stand on the ground, but are not certified or recognized by the state.

Establishment of farmer forest "or SILVO-pastoral system"

But I do want to mention in this writing the history of borders, want to share with the reader System. Unfortunately thousands of traditional forest production year, what's produced as produced within these borders, in a territory in the most modest quotient of less than three hectares for families. Depending on environmental conditions, soil fertility, type of trees, taking system, the respective denominations as Kashnjët, loader, prozhem, grove, ograjë, kojrië, mountain. In essence the aim was that the

wood material produced every year, as during take-off and after stabilization of the system which was more flexible and dynamic. From branches cut leaves are used for fodder for livestock and the remains woody part for heating and cooking. Since the ancient farmer knew this and dependencies of the goal he had, if he would do instead of grazing, fodder for winter wood manufacturing, which had three years that shoots left to grow, by received production first, leaving a certain number to go higher. The owners returned to this coups three years after the other, when standard trees had reached 6 years, the farmer again make shreadings all over the last three adult shoots, follows "the left around the trees." Now it was possible that the "trees for all" to become the treatment, being cut branches established manufacturing nodes, which to begin production on several floors, generally from the height of a man, to produce a branch of foliage periodically every three years.

All coppice lands have one thing in common-they are repeatedly cut down, in the very reasonable expectation that the trees will regrow by themselves. Whether this regrow is the result of new shoots sprouting from cut stumps or tree roots is unimportant: the point is that new canopy forms rapidly and for the main part vegetatively from the old without the need for any great management effort. The process is almost infinitely repeatable. Some woodlands have been coppiced for long periods of their history, often for hundred and sometimes thousand of years

Page 1, 2, 3, 4

MARKERS OF FOREST TREES

Nijazi IDRIZI

In our Kosovo has become ritual marking of trees. Every tree, before it is expected, must undergo ritual marking, the institution of the people who make it.

In the Law on Forests, the key word mark is his. No band can not be expected nor old trees as they were youths. Stamp or marking executables are foresters who are identified with the mark.

For private forest management has no plans, because their owners do not supported by Forest Agency to develop them, will be directed to which of trees, to put it, (where I have to wait and how)? All users of wood, are punished by law, to wait for months foresterst, to put their mark on the trees, otherwise they can not wait. Over 130 thousand households (forest owners), in normal conditions, should in the beginning of the year to March, to address the office of cadastre municipalities, to take possession list, which does not say how much wood is there, for which we need to pay money? He demands, must manage the forest offices, once in the Municipal Government of times. Neither these offices do not have records of the owner forest reserves, to show what should be done, because no plans. These offices have only mark (Hammer). When the owner comes to the lucky moment, forestry with the band on hand to leave his forest. Foresters are extremely important, because they wait in line 130 thousand owners, and not just once!

Page 5

Reforms in the woods looking support in tradition and in experience gained ...

Xhelal SHUTI

Experience gained

1. The main objective has been "Working with people and not with forest". During this period transferred about 60% of Fund-owned forest and pasture local government. This will means that the forests are being taken Service not only structures Forest, but also those of the LGUs. In any municipality where the transfer are raised Association Forest Users' Associations, with a large number members, who discuss, think of contributing to sustainable management of forests. Also, in each county Federation Forest are set Associations, as coordinator of Association representative, as and for identifying problems and lobby the meeting the interests of members. This means that increased number of people who think of work for forests and development in rural areas.
2. Any municipality which is available, the transfer a breeding plan. This plan helps municipal staff to design plans zhvillimi 10 year, whilst giving priority to the most lucrative sector from natural sources area where they live.
3. Village committees, in most cases are included in the transfer process, identifying users traditional boundaries between villages and between users (This, according to areas of special districts).

Page 4

Dear readers of the newspaper "Green Crown"!

We are in the preparatory phase of drafting a new law for Forests and as a very important moment we ask your support, comments, opinions and suggestions about it. Feel free to contact us at any time without hesitating.

Contact persons:

Veli Hoxha: Redaktor Pergjegjes velihoxha@yahoo.com
Albora Kacani E-mail: alborakacani@hotmail.com

Known botanist Antonio Baldacci, here a century ago emphasized that the development of agriculture Albanian is related to the problem of forestry. But there is a difficulty he noted: "... proof of Forest ownership of Albania. first of which all have stabilized are privately owned, which in common use of that

Deficiencies that should not continue indefinitely

Ndriçim ÇELA

state, to avoid objections that arise with thousands and difficult issue that will not be easy to overcome by the government". This time should be carefully, defects of the law not to repeat 7501 for forests

and pastures, to accept old traditions based on codes of millennium (unwritten but act today) created by the community in the course of centuries for the administration forest property.

Page 3

KURORA E GJELBËR

Gazetë e Shoqatës Kombëtare të Pyjeve e Kullotave Komunale, Shqipëri dhe e Asosacionit të pronarëve Privatë, Kosovë

Këshilli Botues: A. Proko, N. Çollaku, V. Tabaku, J. Male, B. Gashi, I. Zeka, B. Hoxha

Kryeredaktor: AHMET OSJA Zv.kryeredaktorë: Nijazi IDRIZI, Ferdin LIÇAJ, Albora KACANI

Redaksia: V. Muharremaj, H. Kola, Gj. Fierza, M. Shehi. Redaktor përgjegjës: V. Hoxha

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina e ZP, kati II, Tiranë

Mobile: 068 40 75 975; e-mail: fkpkk@hotmail.com; velihoxha@yahoo.com

www.fkpkk.org

www.akppp.org

SNV
Connecting People's Capacities

Sida